

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Çështje procedurale (Seancë e hapur)

Faqe 1

1 E hënë, 15 prill 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Deklaratat Përmbyllëse]

4 [I akuzuari paraqitet përmes videolidhjes]

5 --- Seanca fillon në orën 09.30

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Mirëmëngjesi dhe mirë se erdhët në seancën e ditës së sotme.

8 Sekretare e Gjykatës, ju lutem paraqisni lëndën.

9 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi, të nderuar
10 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-04, Prokurori i
11 Specializuar kundër Pjetër Shalës.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

13 Faleminderit.

14 Ju lutem palëve të na thonë kush janë të pranishëm, të
15 fillojmë me Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

16 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të gjithëve. Nga
17 ana e ZPS-së, kemi Prokuroren e posaçme Kimberly West,
18 menaxheren e lëndës, Line Pedersen, stazhierët Xiao Guozhen
19 dhe Ella Palsenbarg. Dhe, gjithashtu, Gaia Pergolo, Eva Wyler
20 dhe unë, Filippo De Menicis.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

22 Faleminderit.

23 Mbrojtës i Viktimave, fjala është për ju.

24 Z. LAWS: [Përkthim] Mirëmëngjesi. Unë jam Simon Laws,
25 Avokati i Viktimave në këtë çështje gjyqësore bashkë me

1 bashkëmbrojtësen Maria Radziejowska.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Mbrojtja, fjala është për ju.

4 Z. GILISSEN: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës.

5 Këtu është z. Shala, që po na ndjek përmes videolidhjes nga
6 objekti i paraburgimit. Kam dy bashkëmbrojtësit, z. Hedi
7 Aouini dhe znj. Cariolou, menaxhere e lëndës, Dzeneta
8 Petravica, një asistente juriste, Kailin Chen dhe dy
9 asistentet e tjera juriste Juliet Kolbe dhe Alana Goncalves
10 dhe z. Basile Mulera, që është stazhier.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Faleminderit.

13 Z. Shala, a më dëgjoni mirë?

14 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Mirëmëngjes. Ju dëgjoj
15 shumë mirë.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
17 mirë. Faleminderit.

18 Do fillojmë sot me deklaratat përmbyllëse. Do ndjekim
19 rendin e ditës që ishte përcaktuar në vendimin e Trupit
20 Gjykes për deklaratat përmbyllëse, që mban numrin e
21 parashtrim të protokolluar 824.

22 Sot do fillojë Zyra e Prokurorit të Specializuar.

23 Seanca do të jetë në seancë publike, me përjashtim të
24 rasteve kur do të kërkohet ndryshe nga palët, Mbrojtësi i
25 Viktimave apo nëse do ta vendosë Trupi Gjykes.

1 E kam parasysh parimin e seancave publike dhe theksoj
2 udhëzimin që kemi dhënë më herët, që palët duhet t'i japin
3 deklaratat përmbyllëse sa më shumë të jetë e mundur në seancë
4 publike. Sidoqoftë, për të garantuar mbrojtjen e viktimave dhe
5 të dëshmitarëve, disa pjesë të seancës do të duhet të mbahen
6 në seancë të mbyllur ose private dhe për këtë qëllim ju
7 rikujtoj të më njoftoni paraprakisht nëse keni nevojë t'i bëni
8 parashtrimet në seancë private apo seancë të mbyllur. Në
9 rregull?

10 Gjithashtu, dua të them diçka me rëndësi. Ju kujtoj të më
11 informoni mua dhe Zyrën Administrative nëse keni prezantime që
12 nuk janë për publikun dhe gjithashtu të na njoftoni kur një
13 dokument nuk duhet të jetë më në ekran. E them këtë sepse kjo
14 ndikon tek ajo që duhet treguar publikut, pra, i duhet treguar
15 apo jo një dokument publikut. Kjo është pikë me rëndësi, në
16 mënyrë që të mos përcjellim për publikun dokumentet që nuk
17 duhet.

18 Gjithashtu, i kujtoj palët dhe Mbrojtësin e Viktimave të
19 respektojnë rregullat për redaktimet në seancën në gjyq. Është
20 një procedurë që e kemi bërë gjithmonë.

21 Dhe, përpara se të fillojmë me deklaratën përmbyllëse të
22 ZPS-së, dua të trajtoj dy pika sa i takon Mbrojtjes.

23 Pikë së pari, Trupi Gjykses merr parasysh se Mbrojtja
24 dorëzoi dosjen gjyqësore përfundimtare, me numër 821, më 21
25 mars të këtij viti, që ishte një ditë pas afatit që kishte

1 caktuar Trupi Gjykses. Në fakt kjo ka ndodhur për disa
2 problematika teknike, siç na e shpjegoi Mbrojtja. Duke marrë
3 parasysh rëndësinë që ka dosja përfundimtare gjyqësore dhe
4 duke qenë se ka pasur arsye për këtë vonesë, ne e pranojmë që
5 ky dokument është një dokument i vlefshëm në përputhje me
6 rregullën 9(5)(b) të Rregullores.

7 Një pikë tjetër lidhet me një pikë në dosjen gjyqësore
8 përfundimtare, ku Mbrojtja rezervon të drejtën për të bërë
9 parashtrime shtesë lidhur me dënimin nëse ka shpallje të
10 fajësisë. Ky është në dokumentin F821, paragrafi 308. Trupi
11 Gjykses i tërheq vëmendje Mbrojtjes sa i takon urdhrin me gojë
12 të Trupit Gjykses të 25 tetorit 2023, mund të shihni
13 transkriptin e të njëjtës datë, që të jemi më konkret, është
14 në faqen 3153, në rreshtin 9, deri në faqen 3156, në rreshtin
15 24 dhe në transkript mund të shihni se është vendosur tashmë
16 se në rast se do ketë shpallje fajësie, dënimi përkatës do të
17 jepet njëherazi me shqiptimin e aktgjykimit në përputhje me
18 rregullën 159(6) të Rregullores.

19 Uroj të jetë e qartë kjo për ju, që çdo parashtrim i
20 kësaj natyre duhet bërë këtë javë në kohën e përshtatshme.
21 Shoh që po pohoni me kokë, Avokat. Faleminderit.

22 Me kaq mbyll fjalën e Trupit Gjykses. Mund të fillojmë me
23 deklaratat përmbyllëse të ZPS-së.

24 Ju janë caktuar pesë orë e gjysmë për parashtrimet tuaja.
25 Ju lutem na njoftoni nëse keni ndryshime nga pikëpamja kohore

1 dhe për momentin fjala është për ju.

2 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kur i
3 akuzuari u largua nga Shqipëria për një jetë në Belgjikë në
4 vitin 1999, mbase ai mendoi se mund t'ia mbathte prej krimeve
5 të tij, nga viktimat e tij dhe t'i linte të gjitha pas. Por
6 nuk u shpëtohet krimeve të luftës. Ata që kanë kryer krime
7 lufte, të nderuar Gjykatës, asnjëherë nuk mund t'i shmangen
8 përgjegjësisë. Ata të ndiqen penalisht kudo që janë dhe sa
9 herë që gjenden.

10 Është falë këtij parimi që ne mund ta sillnim të
11 akuzuarin para jush, të nderuar Gjykatës, sot, që të përballlet
12 me gjykimin e tij. Tani ju kërkohet, të nderuar Gjykatës, ta
13 shpallni fajtor për krimet që ka kryer.

14 Kjo është çështja e dytë që lidhet me krimet e luftës që
15 janë gjykuar në këtë Gjykatë, çështja e parë ka përfunduar,
16 është një çështje për llogaridhënien.

17 Viktimat e krimeve të të akuzuarit nuk mund të
18 largoheshin. Një prej tyre vdiq në fabrikën e metalit të
19 Kukësit. Të tjerët kanë shenja të përhershme fizike edhe
20 përndiqen prej asaj përvoje. Ata nuk mund të harrojnë. Ata dhe
21 familjet e tyre na kanë përshkruar traumën e thellë dhe të
22 gjatë prej të cilës vuajnë.

23 Shumica e dëshmitarëve nuk e kanë rrëfyer për herë të
24 parë historinë e tyre. Këtë e kanë bërë për shumë vite edhe në
25 gjykime të tjera të mëparshme. Megjithatë, ishin të gatshëm të

1 vinin sërish këtu, t'i përjetonin edhe një herë ato ngjarje
2 sepse ende besojnë se ka drejtësi. Dhe këtë drejtësi mund ta
3 ofrojë kjo Gjykatë. Ata besojnë në parimin e llogaridhënies
4 dhe mbi këtë parim është i akuzuar përpara kësaj Gjykate.

5 Akuzat në këtë çështje gjyqësore lidhen me krimet që janë
6 kryer për afërsisht mes datës 17 maj dhe 5 qershor 1999 në një
7 fabrikë të vjetër metali në qytetin e Kukësit në veri të
8 Shqipërisë. Me pak përjashtime, viktimat ishin shqiptarë të
9 Kosovës.

10 Z. Shala, Pjetër Shala, i akuzuari në këtë çështje
11 gjyqësore, akuzohet me krimin e luftës të ndalimit arbitrar,
12 trajtimit mizor, torturës dhe vrasjes së paligjshme.

13 Gjatë periudhës së përcaktuar në aktakuzë ai ka qenë
14 anëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

15 Viktimat në këtë çështje gjyqësore, si burra dhe gra, u
16 shenjësuan nga i akuzuari dhe nga disa anëtarë të tjerë të
17 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe mbi akuza të vagullta dhe
18 të pavërtetuara, u quajtën tradhtarë dhe spiunë. Ata u ndaluan
19 kur ishin në momentet e tyre më të dobëta. U rrëmbyen në rrugë
20 pasi ishin arratisur prej shtëpive të tyre, u morën prej
21 kampeve të refugjatëve ku kishin gjetur strehë në Shqipëri ose
22 u arrestuan teksa përpiqeshin t'i kyçeshin radhëve të Ushtrisë
23 Çlirimtare të Kosovës.

24 Ata u privuan prej lirisë dhe u mbajtën të ndaluar në
25 mënyrë arbitrare në fabrikën e metalit të Kukësit në kushte

1 çnjerëzore dhe u keqtrajtuar nga i akuzuari dhe kryes të
2 tjerë. Ata jetuan me frikë përditë e javë të tëra. Ndalimi i
3 tyre ishte krejtësisht i paligjshëm sipas të drejtës
4 humanitare ndërkombëtare. Dhuna e ushtruar kundër tyre nuk
5 ishte vetëm një dhunë penale por cenonte çdo të drejtë
6 njerëzore standarde.

7 Një prej këtyre viktimave, një shqiptar i ri i Kosovës u
8 arrestua, u rrah egërsisht me ditë të tëra dhe më pas u vra.
9 Ai nuk ishte i rrezikshëm, aspak i rrezikshëm për kryesit, të
10 cilët sidoqoftë vendosën t'i merrnin jetën. I akuzuari ishte
11 një prej këtyre kryesve.

12 Viktima e vrasjes së paligjshme nuk jetoi të shihte
13 fundin e luftës. Ai nuk mundi të festonte me familjen e tij,
14 me shokët e tij dhe me të dashurit e tij. As nuk mund të
15 shihte çfarë e priste vendin e tij, Kosovën pas luftës. I
16 akuzuari dhe kryesit e tjerë ia hoqën këtë mundësi. I hoqën të
17 drejtën që të jetonte, të punonte, të udhëtonte, të
18 dashuronte, mbase dhe të moshohet. Ai nuk mund të qëndronte
19 këtu përpara jush, të nderuar Gjykatës, sot të na tregonte se
20 çfarë i kanë bërë, sesa e frikshme ishte ajo që i ka ndodhur
21 dhe sa shumë e ka lënduar.

22 Viktimat e tjera, ata që mbijetuan, kanë pasoja fizike
23 dhe psikologjike të këtij trajtimi për vite i kanë përjetuar
24 pas kësaj përvoje. Disa prej tyre ende vuajnë prej tyre.
25 Kujtimet e ndalimit që kanë pasur në Kukës ju dalin në gjumë

1 por edhe kur janë zgjuar. 25 vite pas fakteve të kësaj
2 çështjeje gjyqësore, këto kujtime ende ndikojnë jetën e tyre
3 të përditshme, punën e tyre, si dhe thjesht të kenë besim tek
4 të tjerët.

5 Qëndrimi i Prokurorisë është që i akuzuari ka marrë pjesë
6 në këto krime të dirigjuara bashkë me të tjerët, por edhe
7 individualisht dhe ka pasur synim për këtë. Pjesëmarrja e tij
8 ka qenë e vazhdueshme, e konsiderueshme dhe tejet e dhunshme.
9 Të nderuar Gjykatës, do dëgjojmë më shumë lidhur me këtë por
10 në prezantimet e radhës.

11 Qëndrimi i Prokurorisë mbështetet në shtylla të shumta
12 dhe solide. Provat sa i takon përgjegjësisë së të akuzuarit
13 vijnë nga dëshmitarë të ndryshëm dhe dëshmia e tyre ka qenë
14 konsistente dhe konfirmonte dëshminë e njëri-tjetrit. Sa i
15 takon këtyre dëshmive, kemi deklaratën e vetë të akuzuarit. Ai
16 ka pranuar se ka qenë në Kukës gjatë periudhës së përcaktuar
17 në aktakuzë. Po ashtu ka pranuar se ka marrë pjesë në disa nga
18 krimet, ndonëse pranimet e tij në këtë drejtim kanë qenë të
19 pjesshme. Pastaj kemi dëshminë e anëtarëve të UÇK-së që kanë
20 qenë në fabrikë dhe e kanë parë të akuzuarin atje në të
21 njëjtën kohë që kanë thënë dhe viktimat se ai ka qenë pjesë e
22 keqtrajtimit të tyre.

23 Të nderuar Gjykatës, të gjitha përputhen edhe vërteton se
24 ai ka bërë ato për të cilat akuzohet.

25 Jo të gjitha viktimat e patën mundësinë të dëshmonin

1 këtu, fatkeqësisht. Disa prej tyre kanë vdekur përpara se të
2 fillonte ky gjykim, por historitë e tyre janë në deklaratat e
3 mëparshme, në dëshmitë e personave të tjerë që kanë qenë të
4 ndaluar me ta dhe në dëshmitë e anëtarëve të familjes së tyre.
5 Në fakt, vuajtja e tyre është pasqyruar në pranimin e pjesëshëm
6 që ka bërë i akuzuari.

7 Të nderuar Gjykatës, ne duam ta bëjmë të qartë, siç e
8 bëmë të qartë në dosjen tonë, neve nuk po i kërkojmë Trupit
9 Gjykses ta shpallë të akuzuarin fajtor mbi dëshmi që i
10 akuzuari nuk i dëgjoji dot në këtë sallë gjyqi. Por ne kemi
11 dëgjuar shumë dëshmitarë, që kanë konfirmuar dëshmitë e njëri-
12 tjetrit dhe kjo e marrë së bashku me prova të tjera,
13 vërtetojnë akuzat e Prokurorisë përtej dyshimit të arsyeshëm.

14 Të nderuar Gjykatës, si i përgjigjet Mbrojtja akuzave dhe
15 dëshmime që kemi dëgjuar ne që i mbështesim këto akuza?

16 Qëndrimi i Mbrojtjes është që i akuzuari ka qenë një
17 luftëtar lirie. U largua nga Belgjika në 1999 për të shkuar në
18 Shqipëri që të luftonte për lirinë e vendit të tij. Dhe ka
19 qenë vetëm pak herë në fabrikën e metalit të Kukësit ku
20 shkonte për të çuar furnizime dhe më pas kalonte serish në
21 vijën e frontit. I akuzuari, thotë Mbrojtja, nuk asnjë lidhje
22 me krimet për të cilat akuzohet.

23 Mbrojtja shprehet se viktimat që e kanë identifikuar si
24 një nga kryes, këtë si kryes, ose gënjejnë ose kanë gabim ose
25 të dyja bashkë. Të gjithë ata. Nuk ka rëndësi që dhe vetë i

1 akuzuari ka pranuar, në fakt, se i ka rrahur disa prej këtyre
2 viktimave dhe se tha se nuk është dhe pishman dhe se do ta
3 bënte sërish të njëjtën gjë.

4 Dëshmitarët e Mbrojtjes, të nderuar Gjykatës, pretendojnë
5 se nuk e kanë parë asnjëherë Pjetër Shalën në fabrikën e
6 metalit në Kukës dhe madje që nuk e dinin dhe kush ishte. Por,
7 të nderuar Gjykatës, këta janë të njëjtit dëshmitarë që thonë
8 që nuk kanë parë asnjëherë objektin e ndalimit në mes të
9 fabrikës së metalit të Kukësit. Një ndërtesë para së cilës
10 kalonin me muaj të tërë - me muaj të tërë - gjatë kohës që
11 shërbenin për UÇK-në, që është e pamundur të mos e shohësh,
12 siç dhe do ta shihni vetë në prezantimin e kolegëve të mi pas
13 fjalës sime. Ata nuk e panë asnjëherë këtë ndërtesë dhe
14 asnjëherë nuk panë të akuzuarin.

15 Dëshmia që keni dëgjuar ju, të nderuar Gjykatës, është e
16 thjesht, këta dëshmitarë nuk tregonin të vërtetën. Por,
17 viktimat nuk gënjenin. Historitë e tyre përputheshin dhe
18 konfirmohen nga deklaratat e të vetë të akuzuarit.

19 Dënimi që kërkon ZPS-ja vjen si rezultat i një shqyrtimi
20 të kujdesshëm i të gjithë faktorëve përkatës por veçanërisht i
21 sjelljes së të akuzuarit, të veprimeve të tij dhe të pasojave
22 që shkaktuan këto veprime.

23 Kontributi që ka dhënë ai në këto krime ka qenë i
24 konsiderueshëm. Ai ka ushtruar një dhunë të frikshme
25 përkundrejt viktimave të terrorizuara. Të nderuar Gjykatës, të

1 rrahësh persona që nuk mund të mbrohen nuk është luftë. Është
2 një akt frikacak i pajustificueshëm dhune.

3 I akuzuari nuk bëri asgjë për t'ua lehtësuar dhimbjen. Më
4 së paku duhet të ishte larguar gjatë kohës që ndodhnin këto
5 mizori po ai nuk e bëri. Ai rrahu njëri pas tjetrit. Dhe koha,
6 të nderuar Gjykatës, nuk e ka ndryshuar karakterin e tij. Për
7 të gjitha këto arsye ai meriton dënim të rëndë.

8 Znj. Wyler, e cila është ulur në të majtën time, do t'ju
9 tregoj ju dhe publikut vendin brenda fabrikës së përpunimit të
10 metaleve ku i akuzuari dhe kryes të tjerë i kanë kryer këto
11 krime. Ajo do t'ju tregoj ju sesi trajtimi i viktimave çoi në
12 krimin e ndalimit arbitrar, trajtimit mizor dhe torturës.

13 Znj. Pergolo më pas do të diskutojë incidentet të cilët
14 janë përcaktuar dhe përshkruar më tej në seksionet 5E dhe 5F
15 të dosjes së Prokurorisë. Ajo do të t'ju tregojë që vrasja
16 është kryer. Do të trajtojë gjithashtu dhe çështje që lidhen
17 me besueshmërinë e dëshmitarit dhe do t'i përgjigjet
18 pretendimeve konkrete të Mbrojtja lidhur me këtë pikë.

19 Më pas do ta marr unë përsëri fjalën për t'ju ilustruar
20 dhe një herë kohën e përfshirjes së të akzuarit në krimet e
21 ngritura në aktakuzë, do të diskutoj gjithashtu edhe
22 përgjegjësinë penale sipas ligjit të zbatueshëm. Dhe, në fund
23 fare, të nderuar Gjykatës, do t'i përgjigjem pretendimeve të
24 caktuara që kanë të bëjnë me besueshmërinë e Dëshmitarit numër
25 1. Do ta bëj në fund këtë gjë sepse një pjesë e kësaj do të

1 duhet që të trajtohet në seancë private. Pra, më mirë sesa të
2 ndërpres prezantimin tim për publikun, preferoj që këtë pikë
3 të mund ta trajtoj në fund të prezantimit në mënyrë të tillë
4 që të kërkoj vetëm një herë që të kalojmë në seancë private.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë
6 mirë.

7 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Tani znj. Wyler do të marrë
8 fjalën nga Prokuroria.

9 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës
10 dhe kolegë. Në rreth 30 minutat në vijim, unë do t'ju
11 përshkruaj juve dhe publikut vendin ku ka ndodhur makthet e
12 kësaj çështjeje, do t'ju përshkruaj gjithashtu edhe ambientet
13 e fabrikës së përpunimit të metaleve në Kukës në vitin 1999,
14 që në këtë vit u bë vendi ku janë kryer ndalimet arbitrare,
15 trajtimi mizor, torturat dhe vrasja.

16 Dëshmitë e detajuara, të hollësishme të personave që i
17 kanë mbijetuar keqtrajtimit dhe torturës në fabrikën e
18 metaleve në Kukës janë pjesë e dosjes gjyqësore përfundimtare
19 të ZPS-së. Sot përpara jush, Trupit Gjygues, publikut unë do
20 t'ju bëj një përshkrim të shkurtër të ngjarjeve që kanë
21 ndodhur në fabrikën e përpunimit të metaleve në Kukës dhe
22 cilat janë dëshmitë të cilat vërtetojnë katër pikat e ngritura
23 në aktakuzë kundër këtij të akuzuari.

24 Gjatë këtij procesi gjyqësor, të nderuar Gjykatës, ju
25 keni dëgjuar dëshmi të viktimave dhe dëshmitarëve të cilët me

1 kurajë kanë ardhur përpara jush për të dëshmuar dhe duke ju
2 përshkruar juve, persona të dashur për ta dhe sesi ata janë
3 mbajtur pa asnjë arsye në fabrikën e përpunimit të metaleve në
4 Kukës në kushte çnjerëzore. Ata kanë përshkruar abuzimet e
5 përsëritura, rrahjet mizore dhe mënyrën sesi ata janë
6 torturuar. Historitë e tyre janë koherente, janë të
7 konfirmuara prej njëra-tjetrës dhe janë konsistente. Dëshmitë
8 vërtetojnë të gjithë elementet e krimeve të ngritura në
9 aktakuzë si dhe përgjegjësinë e të akuzuarit Pjetër Shala për
10 këto krime.

11 Krimet pjesë e kësaj aktakuze kanë ndodhur të gjitha në
12 Kukës, që është një qytezë e vogël në Shqipëri që gjendet
13 mesatarisht 20 kilometra larg kufirit nga Kosova, në shtabin
14 lokal të UÇK-së të asaj kohe, që tani mund ta shikoni të
15 shënjuar me të kuqe në hartën që keni përpara. Shtabi i UÇK-së
16 është vendosur në ambientet e një fabrike të vjetër të
17 përpunimit të metaleve në Kukës. E gjendur në rrugën që shkon
18 në Krumë, që tani e kemi shënjuar me të kuqe, kjo fabrikë
19 kishte një portë hyrëse, që mund ta shikoni me anë të
20 shigjetës me të kuqe po ashtu në ekran.

21 UÇK-ja i përdorte këto mjedise si qendër për mobilizimin
22 dhe për logjistikën për operacione ushtarake të kryera,
23 ndërmjet të tjerash, në kufirin ndërmjet Kosovës dhe
24 Shqipërisë. Megjithatë, sikurse është përshkruar edhe në
25 dosjen përfundimtare të gjykimit të ZPS-së, disa pjesëtarë të

1 UÇK-së, përfshirë këtu dhe të akuzuarin, i kanë përdorur këto
2 ambiente apo këto vende për kryerjen e krimeve kundër të
3 paktën 18 viktimave. Askush prej këtyre viktimave nuk ka marrë
4 pjesë në luftime, nuk ka marrë pjesë aktive në luftime në atë
5 kohë, në kohën kur janë arrestuar, kur janë ndaluar apo kur
6 janë keqtrajtuar, ose në rastin e njërit prej të ndaluarve, në
7 rastin kur ai është vrarë. Asnjë prej tyre nuk përbënte asnjë
8 lloj kërcënimi ushtarak për UÇK-në. Në çdo rast, kur kanë qenë
9 nën ruajtjen e personave që i kanë kapur ata, ata të gjithë
10 kanë pasur të drejtë që të gëzojnë mbrojtjen që i ofron Neni 3
11 i Konventave të Gjenevës.

12 Viktimat janë arrestuar, janë marrë dhe janë dërguar në
13 fabrikën e përpunimit të metaleve ku edhe janë ndaluar - disa
14 prej tyre janë mbajtur për disa ditë, ndërkohë që të tjerë
15 janë mbajtur për më tepër sesa një muaj. Nuk ekzistonte asnjë
16 lloj arsyeje, nuk i janë dhënë atyre asnjë lloj arsyes për
17 arrestimin e tyre përveç se disa akuzave të përgjithshme të
18 pabazuara që ishin tradhtarë, bashkëpunëtorë, apo spiunë.
19 Ndërkohë që janë marrë në pyetje në mënyrë të vazhdueshme, ata
20 asnjëherë nuk kanë dalë përpara një gjykatësi apo përpara
21 asnjë autoriteti kompetent apo asnjëherë nuk u është dhënë
22 mundësia që të kundërshtojnë ndalimin e tyre. Në rastin e tyre
23 nuk është ndjekur asnjë garanci procedurale. Dhe për këtë dua
24 që t'i referohem paragrafëve 328 deri në 337 të dosjes
25 përfundimtare të çështjes nga ZPS-ja. Megjithatë, siç mund të

1 kuptohet, ndalimi i tyre ishte arbitrar dhe duke qenë kështu
2 edhe i paligjshëm.

3 Në fabrikën e përpunimit të metaleve në Kukës, krimet e
4 ngritura në aktakuzë kanë ndodhur kryesisht në dy vende: Në
5 ndërtesën që ne e njohim ndryshe ndërtesa e komandës, të cilën
6 mund ta shikoni të shënjuar me të kuqe në pjesën e djathtë
7 poshtë të pamjes që keni përpara dhe në godinën e ndalimit, që
8 tani e keni të rrethuar me të kuqe diku nga qendra e
9 fotografisë që përsëri e keni përpara ekranit. Në këto dy
10 godina, në këto dy ndërtesa, viktimat kanë vuajtur vuajtje që
11 nuk ka fjalë t'i përshkruajmë.

12 Le t'iu shohim pak nga afër këto dy godina përmes modelit
13 3D të përdorur nga ZPS-ja.

14 Për të shkuar tek ndërtesa e komandës, duhet të futesh
15 tek fabrika e përpunimit të metaleve përmes portës kryesore.
16 Është e njëjta portë që kanë kaluar dhe viktimat në momentin
17 kur janë futur në godinën e fabrikës. Në momentin kur futesh,
18 ndërtesa e komandës është në të majtë. Është një ndërtesë prej
19 dy katesh, mund ta shikoni, besoj, në fotografinë që e keni
20 përpara ekranit në të djathtë, në këtë ndërtesë UÇK-ja,
21 anëtarët e UÇK-së kanë fjetur, kanë ngrënë dhe kanë
22 keqtrajtuar gjithashtu të ndaluarit. Të akuzuarit e kanë
23 përshkruar këtë ndërtesë si "zemrën e shtabit ose qendrën më
24 të rëndësishme të shtabit".

25 Dera e ndërtesës së komandës, që tani e keni të shënjuar

1 me të kuqe dhe që është zmadhuar dhe mund ta shikoni më qartë
2 në ekran, ka çuar në një zonë hyrjeje më të ulët. Përballë
3 derës, përtej zonës së hyrjes, ka një palë shkallë të cilat të
4 çojnë në katin e parë. Mund të shikoni këtë pjesën e shkallëve
5 që të çojnë në katin e parë. Ndërkohë muri që mund të shikoni
6 në të majtë të kësaj fotografie është muri që ndante godinën
7 ku mbaheshin të ndaluar personat e ndaluar në Kukës, që mund
8 ta shikoni këtu.

9 Pra, kjo është dhoma ose kjo është hapësira ku Dëshmitari
10 1448 është dërguar kur është dërguar në fabrikën e përpunimit
11 të metaleve në Kukës rreth datës 18 maj 1999. Dëshmitari 1448,
12 një shqiptar Kosove, punonjës si emigrant në Gjermani, kishte
13 udhëtuar në Shqipëri për të vizituar familjarët e vet por u
14 arrestua nga UÇK-ja përpara sesa mund të takohej me ta. Në
15 këtë pamje të ndërtesës së komandës, që e keni, besoj, përpara
16 ekranit tani, Dëshmitari 1448 e ka shënjuar, e ka etiketuar
17 këtë dhomë si "burgu ose vendi i ndalimit" në pjesën e sipërme
18 të godinës.

19 Dëshmitari 1148 dhe 4733 që është viktima e vrasjes edhe
20 ky gjithashtu shqiptar i Kosovës, ka vuajtur ndalimin së
21 bashku me Dëshmitarin 1448. Ata janë ndaluar në këtë hapësirë
22 të errët, në hapësirë të vogël, në një hapësirë që nuk kishte
23 asnjë dritare, kanë pasur në dispozicion vetëm disa batanije
24 të vjetra dhe të pista dhe vetëm me shishe të mbushura me
25 urinë.

1 Një mbrëmje vonë, ka qenë rreth datës 20 maj të vitit
2 1999, Dëshmitari 4733 është nxjerrë nga kjo dhomë, është
3 dërguar poshtë, domethënë, ka zbritur shkallët, përmes
4 korridorit në katin predhës dhe është dërguar në një zyrë në
5 një natë ku ndodhur rrahjet më brutale dhe më të tmerrshme të
6 mundshme.

7 Dëshmitari 1 i këtij procesi gjyqësor, i cili gjithashtu
8 është dërguar dhe është rrahur në këtë dhomë të njëjtën datë
9 të njëjtën natë, e ka shënuar këtë dhomë gjatë dëshmisë që ka
10 dhënë përpara jush, të nderuar Gjykatës edhe e ka shënuar atë
11 me këtë pikën ose vijën ngjyrë blu që është e identifikuar në
12 ekran. Ai e identifikoi "zyrën e tretë" në katin përdhe'.

13 Dëshmitari 1448, është dërguar përsëri në të njëjtën
14 dhomë të njëjtën natë dhe edhe po ky e ka treguar vendndodhjen
15 e kësaj dhome në skicën që ka bërë për ndërtesën e komandës.
16 Ai ka identifikuar gjithashtu dhomën e tretë në katin përdhes
17 dhe e ka identifikuar atë si "dhomën e rrahjeve".

18 Pjesa e brendshme e kësaj dhome mund të tregohet përmes
19 një videoje që është regjistruar rreth datës 2 qershor 1999
20 nga Dëshmitari 3887. 3887 identifikoi vendin e kësaj dhome të
21 treguar në video gjatë dëshmisë që ka dhënë përpara jush, të
22 nderuar anëtarë të Trupit Gjyqësor dhe ai e ka shënuar këtë
23 vend me numrin 2. Nuk ka pikë dyshimi që bëhet fjalë për të
24 njëjtin vend, për të njëjtën dhomë që është identifikuar dhe
25 nga viktima të tjera. Për çështje krahasimi, mund të shikoni

1 shënimet e Dëshmitarit numër 1 në të majtë.

2 Videoja që do ju tregoj tani do ju tregoj shkurtimisht
3 një bashkim ose një grumbullim të rreth 10 ushtarëve të UÇK-
4 së. Do ju ftoj që ta shikoni tani.

5 [Luhet videoincizimi]

6 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Është një video e cila tregon
7 pjesën e brendshme të kësaj dhome. Mund të shikojmë një krevat
8 dy katesh, krevat marinari. Mund të shikojmë që ka edhe një
9 mobilie diku në cep, ka një tavolinë në mes të dhomës dhe ka
10 edhe stola për t'u ulur.

11 Kur Dëshmitari 4733 është dërguar në atë dhomë vonë në
12 mbrëmjen e datës 20 maj 1999 a rreth kësaj date, ai përshkroi
13 bashkime të ngjashme ose mbledhje të ngjashme siç ajo që sapo
14 pamë në video ndërmjet ushtarëve të UÇK-së. Dhe atë natë grupi
15 përfshinte të akuzuarin, Sabit Gecin dhe Xhemshit Krasniqin.
16 4733 kujtoi në dëshmitë e mëparshme, për shembull, në faqen 2
17 të dëshmisë së dëshmitarit që i ka dhënë TPNJ-së në vitin
18 2002, që kur ai është futur në dhomë, ushtarët e UÇK-së ishin
19 duke pirë. Ata me sarkazëm e kishin ftuar për një mbledhje në
20 nder të tij dhe ai thotë që ajo natë ka qenë një ndër netët e
21 keqtrajttimeve më brutale. Atë natë, Dëshmitari 4733, 1448,
22 Dëshmitari numër 1 në këtë çështje gjyqësore, viktima e
23 mbrojtjes dhe të ndaluar të tjerë kanë duruar dhunë të
24 pabesueshme.

25 Pjesa më e mëdha e viktimave të asaj nate ishin shqiptarë

1 të Kosovës. Dhe akuzoheshin për lidhje me institucionet serbe,
2 akuzoheshin se ishin bashkëpunëtorë të Serbisë dhe për këto
3 akuza rriheshin me çfarëdolloj gjëje që mund të gjenin
4 ushtarët e UÇK-së, që mund të ishin shkopa bejsbolli, mund të
5 ishin shkopa të ndryshëm prej hekuri, me pjesët e pushkës e të
6 tjera.

7 Ata që i kanë rrahur i kanë rrahur aq keq viktimat deri
8 në atë pikë sa trupat e tyre u nxinë të tërë dhe që ata kanë
9 humbur ndërgjegjen. Një viktimë kujton që i akuzuari qeshte
10 ndërkohë që e ka goditur atë. Ndërkohë që Dëshmitari 4733 ka
11 thënë që i akuzuari e ka rrahur atë "si një kalë".

12 Ndërkohë që viktimat faniteshin kryesit ju hidhnin ujë në
13 mënyrë të tillë që ata të fitonin përsëri ndërgjegjen, në
14 mënyrë që të vazhdonin që t'i keqtrajtonin më tej. Ata ishin
15 të mbushur, të mbuluar me gjak. Rrahjet që i kishin bërë i
16 kishin shkaktuar dhimbje të pabesueshme. Dhe pavarësisht kësaj
17 kryesit nuk mjaftoheshin me kaq por ju hidhnin kripë në sy dhe
18 në plagë.

19 Përveç rrahjeve, Dëshmitari 4733, për shembull, në mënyrë
20 të vazhdueshme është djegur me cigare dhe i kanë futur me zor
21 një shkop në gojë duke i thyer dhëmbët. Në rastin e një
22 viktime tjetër, kryesit kanë vendosur një qese plastike në
23 kokën e tij, e kanë lidhur rreth e qartë kokës dhe i kanë
24 hedhur ujë në kokë.

25 Në të gjithë këtë situatë të tmerrshme, viktimat janë

1 keqtrajtuar. Dhe, gjithashtu, në rastin e dëshmitarit në fjalë
2 ai është detyruar që të keqtrajtojë dëshmitarë të tjerë. Për
3 shembull, Dëshmitari 1448 u detyrua që të shikonte torturën e
4 Dëshmitarit 4733 dhe ai kujton që "ishte një lloj konkurrence
5 sesi mund të rrihej më tepër ose sesi mund të lëndoheshin
6 njerëzit sa më shumë të ishte e mundur".

7 Këtë natë edhe në rrethana të tjera, viktimat kanë qenë,
8 kanë vuajtur në mënyrë të vazhdueshme keqtrajtim të
9 vazhdueshëm dhe të gjatë nga i akuzuari dhe bashkëkryesit e
10 tij me synimin kryesor për të shkaktuar lëndime maksimale. Në
11 të njëjtën kohë, ata kanë qenë objekt i akuzave të tmerrshme,
12 akuzave lënduese se ishin spiunë dhe bashkëpunëtorë dhe, në
13 fakt, këto ishin akuza të cilat nuk kishin fare asnjë lloj
14 baze, po ashtu ata janë marrë në pyetje në mënyrë të
15 vazhdueshme. Kryesit në mënyrë të vazhdueshme i kanë abuzuar
16 ata pavarësisht lëndimeve të dukshme, pavarësisht gjakut në
17 fytyrat dhe në trupat e tyre dhe pavarësisht kushteve të
18 tmerrshme të viktimave të cilët janë fanitur herë pas here dhe
19 disa prej tyre kanë humbur ndërgjegjen herë pas here. Sikurse
20 theksohej gjithashtu edhe në dosjen përfundimtare të ZPS-së në
21 paragrafët 349 deri në 355, kjo cilësohet si keqtrajtim, këto
22 janë lloje keqtrajtimesh të cilat cilësohen si torturë.

23 Në veçanti, pjesëmarrja e të akuzuarit në këtë rast. Së
24 pari dhe mbi të gjitha, i akuzuari që ka bërë pranime të
25 pjesshme sa i takon pjesëmarrjes së tij në këtë incident. Ai

1 ka pranuar veçanërisht se ka rrahur dy viktima, siç
2 parashtrohet në paragrafët 206 dhe 204 të dosjes përfundimtare
3 të ZPS-së. Përveç kësaj, Dëshmitar 1, Dëshmitari 1448, 4733 të
4 gjithë konfirmojnë në mënyrë të përsëritur praninë e të
5 akuzuarit atë natë dhe kontributin e dhunshëm për keqtrajtimin
6 e secilit prej tyre. Dëshmitari 01448 tha që "Ujku", "Ujku i
7 ka rrahur ata të gjithë".

8 Mbrojtja mundohet që të theksojë faktin që Dëshmitari 1,
9 1448 dhe 4733 kanë parë me sytë e tyre rrahjen mizore të
10 njeri-tjetrit atë natë, në veçanti duke theksuar dallimet e
11 pretenduar të dëshmisë së 4733 të cilat parashtrohen më tej në
12 dosjen përfundimtare të gjykimit, në paragrafin 132.

13 Nga hollësitë që mbajnë mend të dy, si Dëshmitari numër 1
14 i procesit gjyqësor dhe si dhe Dëshmitari 4733 - dhe siç
15 diskutohet në paragrafët 135, 140 deri në 141 të dosjes së
16 Prokurorisë - është e qartë që në atë moment ata dy ishin në
17 të njëjtën dhomë. Në atë kohë, Dëshmitari 4733 ishte rrahur
18 keq deri në atë pikë sa kishte humbur vetëdijen. Një plagë në
19 kokën e tij po rridhte gjak pa fund dhe pas pak çastesh ai u
20 nxor nga dhoma dhe në atë moment ishte në një gjendje të
21 tmerrshme. Duke e marrë parasysh kushtet e tij në këtë moment,
22 është e kuptueshme që Dëshmitari 4733 mund të ketë pasur
23 paqartësi sa i takon numrit ekzakt të viktimave të tjera të
24 cilët kanë qenë në një dhomë me të në kohën kur ai është
25 keqtrajtuar. Ndryshe nga ajo çfarë parashtrohet nga Mbrojtja,

1 kjo nuk cenon besueshmërinë ose mbështetshmërinë e Dëshmitarit
2 4733.

3 Pasi u rrahën në zyrën në katin predhës në ndërtesën e
4 komandës, Dëshmitari 4733, 1448 dhe viktima e vrasjes u sollën
5 në katin më sipër në dhomën e ndalimit në ndërtesën e
6 komandës, ndërsa TW1 u çuan në ndërtesën e ndalimit. Tre të
7 ndaluarit që mbetën në ndërtesën e komandës i çuan pastaj atje
8 në ditët në vijim. Tani flasim për këtë.

9 Tani largohemi nga ajo ndërtesa e komandës dhe kalojmë
10 tek depot e mëdha që janë rreth e përçark. Në anën tjetër të
11 oborrit nga ndërtesa e komandës, ndërtesa e komandës ishte në
12 mes të këtyre objekteve. Ndërtesa e ndalimit është vendi i
13 dytë kryesor ku viktimat janë mbajtur të ndaluar dhe janë
14 keqtrajtuar. Tani mund të shihni një fotografi sesi dukej
15 ndërtesa nga jashtë.

16 Në pjesën brenda, ndërtesa e ndalimit kishte tre dhoma -
17 dy dhoma për të mbajtur të ndaluar të ndaluarit, të shënuara
18 në këtë skicë nga T1 si dhoma 1 dhe 3 dhe një dhomë për të
19 torturuar të ndaluarit, e shënuar me numrin 2.

20 Në fotografi mund të shohim dritaret e dhomës 1 nga e
21 cila shihet oborri, tani është i rrethuar me të kuqe në skicën
22 në fotografi. Shënuar me ngjyrë të gjelbër është hyrja, porta
23 hyrëse në ndërtesë e ndalimit, që të çon në korridorin mes
24 dhomës 1 dhe 2. Dëshmitari në Gjykatë 1 ka identifikuar, e
25 shënoi këtë në të njëjtën pikë ashtu si Dëshmitari 10 në

1 dëshminë e tij përpara juve të nderuar më datën 1 maj 2023 në
2 faqen 1055 në transkript dhe shënuar aty.

3 Në ndërtesën e ndalimit, vuajtja e viktimave vazhdoi.
4 Kushtet e ndalimit në ndërtesën e ndalimit ishin çnjerëzore.
5 Të ndaluarit u mbajtën në dhoma të vogla, në temperatura
6 jashtëzakonisht të larta, të padurueshme. Qasja në kontejnerët
7 e ujit jashtë ndërtesës varej nga vullneti apo dëshira e mirë
8 e ushtarëve të UÇK-së, të cilët i goditnin dhe i thernin me
9 thika ata gjatë rrugës që shkojnë për të marrë ujin. Një
10 trajtim i ngjashëm i priste edhe në momentet kur ata kishin
11 nevojë të përdornin tualetet që ishin jashtëzakonisht të
12 pista. Pra, ata janë përpjekur që të mos i përdorin këto
13 nevoja dhe kanë preferuar që të jenë të etur dhe të
14 përballojnë keqtrajtimin e mëtejshëm.

15 Në dhomën 1, mbaheshin deri në 13 të ndaluar në të
16 njëjtën kohë, të grumbulluar në këtë hapësirë të vogël që
17 ishte rreth 3 me 5 metra e madhe. Nuk kishte mobilie. Të
18 ndaluarit kanë fjetur ose në dyshejen e prishur të betonit
19 dhe për një kohë të shkurtër kanë pasur ca dyshekë të hollë
20 apo batanije ose shtriheshin rreth murit duke përdorur duart
21 si jastëk. Nuk kishte ushqim. Në disa ditë u jepnin vezë të
22 ziera, një peshk, apo ato që kishin ngelur nga ushqimi që
23 hanin ushtarët e UÇK-së. Në disa ditë të tjera nuk hanin fare.
24 Nuk kishin mundësi të laheshin apo të ndërronin rrobat.
25 Dëshmitari 4733 i kujtohet era dhe ai thotë që ne na vinte era

1 "si kafshë".

2 Në dhomën 3, të paktën gjashtë të ndaluar janë mbajtur
3 aty. Me një përjashtim, të ndaluarit kanë fjetur në dysheme
4 dhe kishin vetëm ca batanije për t'i shtruar. Ndryshe nga ata
5 që mbaheshin në dhomën numër 1, të ndaluarit në këtë dhomë u
6 është dhënë ushqim edhe supë me ujë.

7 Disa të ndaluar janë detyruar që të bëjnë punë të
8 detyruar duke shkarkuar kamionë apo duke pastruar tualetet.

9 Në dosjen gjyqësore përfundimtare, Mbrojtja pranon se
10 kushtet e imponuara ndaj të ndaluarve në fabrikën e metalit në
11 Kukës ishin "të këqija", por pretendon se kjo ka qenë standard
12 i përgjithshëm në fabrikën e metalit në Kukës dhe se ushtarët
13 e UÇK-së jetonin në kushte të ngjashme. Lista e kushteve të
14 cilat pretendohen që janë të krahasueshme, pra, të ushtarëve
15 të UÇK-së në paragrafët 107, 109 në dosjen përfundimtare të
16 Mbrojtjes nuk i afrohet fare asaj që kanë vuajtur të
17 ndaluarit.

18 Mbrojtja krahason të ndaluarit që mbaheshin aty kundër
19 vullnetit të tyre, të pambrojtur ndaj tekave të torturuesve të
20 tyre me ushtarët e UÇK-së duke pretenduar që kanë qëndruar në
21 Kukës bazuar në vullnetin e tyre dhe që kishin mundësi të
22 largoheshin nga fabrika e metalit nga këto ambiente dhe që të
23 kujdeseshin për veten e tyre dhe nevojat e tyre. Ata krahasojnë
24 të ndaluar që po vdisnin nga uria me ushtarë të UÇK-së të
25 cilët nuk kishin qasje në ushqim të gatuar për me ditë me

1 radhë dhe që vetëm kishin mundësinë të hanin kanoçe apo ushqim
2 të thatë. Krahasojnë të ndaluarit të frikësuar që përdornin
3 tualetet për të marrë ujë me keqtrajtimin që i priste ata
4 gjatë kohës që do të shkonin atje për të marrë këtë ujë dhe
5 kishin mundësi vetëm që të shkonin tek këto vende dhe t'i
6 shfrytëzonin këto me lejen e atyre që i mbanin të ndaluar.
7 Krahasonin të ndaluarit të cilët ishin të grumbulluar të
8 gjithë në një dhomë të vogël ku nuk mund të qëndronin në këmbë
9 apo të shtriheshin në të njëjtën kohë, të cilët nuk kishin
10 asgjë përveçse disa batanije apo dyshekë të vegjël në të
11 rastet me të mira, me ushtarët e UÇK-së të cilët lëviznin të
12 lirshëm dhe flinin në dyshekë dhe batanijet e duhura.

13 Për të justifikuar këtë vuajtje që u shkaktoi të
14 ndaluarve, Mbrojtja gjithashtu paraqet dhe përdor argumentin e
15 furnizimit të përgjithshëm, duke përmendur mungesën e ujit
16 dhe të elektricitetit. Kushtet e mjerueshme të cilat ju
17 imponoheshin të ndaluarve në fabrikën e metalit nuk ishin për
18 shkak të faktorëve të jashtëm, por ishin të qëllimshme dhe të
19 mirëmbajtura aty. Vuajtja që u është imponuar atyre nga
20 kryerësit, të cilët dhe kanë vendosur që t'i mbajnë ata në
21 dhoma të papërshtatshme, në temperatura të padurueshme, pa
22 asnjë mundësi për të pushuar dhe për ta bërë qasjen e tyre të
23 furnizimi me ujë apo në tualete një si sfidë për ta.

24 Pretendimi i Mbrojtjes në paragrafin 110 dhe 111 në
25 dosjen e tyre përfundimtare se te të ndaluarit në fabrikën e

1 metalit në Kukës në përgjithësi kishin qasje dhe u jepej, u
2 ofrohej trajtim mjekësor është keqinterpretim i provave. Në
3 fakt ishte një infermieri dhe kishte staf mjekësor në fabrikën
4 e metalit në Kukës. Kjo përkujdesje megjithatë nuk u jepej të
5 ndaluarve. Apo në raste të rralla atyre u është dhënë trajtim,
6 kur u jepej trajtim, ajo është ndaluar nga ushtarë të UÇK-së
7 pavarësisht plagëve të tmerrshme që ata kishin pësuar gjatë
8 rrahjeve.

9 Pra, kur Dëshmitari 4733 pati një plagë të madhe të
10 thellë në kokë gjatë incidentit të datës 20 maj 1999 dhe kur
11 kësaj ju vu fasho, për shembull, ushtarët e UÇK-së që
12 torturuan 4733 menjëherë e prenë atë, e hoqën atë fasho. 4733
13 u trajtua përsëri dhe ju vu fasho për herë të dytë por edhe
14 atëherë iu hoq. Gjithashtu, mjekimi që 4733 mori për çështje
15 të diabetit që kishte u ndalua menjëherë nga ushtarët e UÇK-së
16 edhe pse e dinin përse ai vuante nga kjo sëmundje.

17 Asnjë nga plagët që viktimat pësuan gjatë keqtrajtimit të
18 tyre nuk është trajtuar në mënyrë të duhur duke lënë viktimat
19 me pasoja të përjetshme. Do t'i kthehem kësaj pike më vonë.

20 Për sa i përket viktimës së vrasjes, mohimi i
21 keqtrajtimit mjekësor pati pasoja fatale ashtu siç kolegia
22 ime, znj. Pergolo, do ta sqarojë, do ta shtjellojë më vonë.

23 Sidoqoftë, në rrethana përgjithësisht të këqija dhe
24 mungesa e burimeve nuk mund të justifikojë kushtet e trajtimit
25 të mbajtjes çnjerëzore. Më shumë këto do të kërkonin që të

1 ndaluarit të liroheshin. Dhomat e Jashtëzakonshme në Gjykatën
2 e Kamboxhias kanë gjykuar në aktgjykimin në çështjen 002/02,
3 datë 16 nëntor 2018, paragrafi 734, 739, duke cituar edhe
4 jurisprudencën e TPNJ-së, që "edhe kur rrethanat në kohën e
5 kryerjes së krimeve janë të vështira për shkak të mungesës së
6 burimeve, burimet që nuk janë të disponueshme duhet të
7 sigurohen dhe të ndërmerren masa të tjera për të zbutur
8 ndikimin dhe impaktin në viktimat". Ekziston një standard
9 minimal i trajtimit që është i nevojshëm të sigurohet në çdo
10 rrethanë. Në qoftë se kjo nuk është e mundur, viktimat nuk
11 duhet të vendosen në një situatë që i ekspozon ato ndaj
12 shkeljes së të drejtave të tyre themelore.

13 Përveç kushteve më tej kushteve të tmerrshme të
14 mjerueshme dhe ngjarjeve konkrete të datës 20 maj 1999 dhe
15 keqtrajttimeve që znj. Pergolo, kolegia ime, do t'i shtjellojë
16 pak më vonë, të ndaluarit në dhomën 1 të ndërtesës së ndalimit
17 janë rrahur, frikësuar, privuar nga gjumi dhe kërcënuar
18 pothuajse çdo ditë.

19 Që t'ju jap disa shembuj. Gjatë këtyre keqtrajttimeve,
20 Dëshmitari në Gjykatë 11 është goditur me grusht kaq shumë në
21 sy sa që goditja e ka lënë me pasoja në shikim deri në vitin
22 2023. 4733 është goditur me shkelm në gojë dhe i janë thyer
23 dhëmbët. Tre muzikantë romë nga Prizreni janë "rrahur sikur të
24 ishin kafshë", sipas fjalëve të Dëshmitarit 4733. Dëshmitari
25 në Gjykatë 1 është rrahur kaq rëndë sa që kur është sjellë

1 përsëri në dhomën ku temperatura ishte e padurueshme në dhomën
2 1 në ndërtesën e ndalimit, ai dridhej.

3 Të ndaluarit janë detyruar që të rrahur njëri-tjetrin,
4 përfshirë edhe në pjesët gjenitale. Ata janë qëllimisht
5 detyruar që dëshmitarët të shikojnë rrahjen e të
6 bashkëndaluarve në dhomën e ndalimit dhe të mund të dëgjonin
7 klithmat dhe bërtitjet e të ndaluarve që rriheshin në dhomën
8 1. Të ndaluarit që ktheheshin nga marrjet në pyetje të
9 dhunshme nxirreshin jashtë dhe mbanin, kishin shenja të
10 rrahjes.

11 Gjatë këtij gjykimi, të nderuar Gjykatës ju keni dëgjuar
12 sesi viktimat kanë vuajtur nga kushtet e ndalimit çnjerëzore
13 dhe keqtrajtme të rënda, sa poshtëruese ishte dhe sa e rëndë
14 ishte dëmi fizik dhe mendor, për të cilat ata vuajnë akoma
15 sot. Disa prej tyre në provat vërtetojnë përtej dyshimit të
16 arsyeshëm se i akuzuari dhe pjesëtarë të tjerë të UÇK-së kanë
17 nënshtruar këta të ndaluar në fabrikën e metalit ndaj
18 trajtimit mizor dhe torturës.

19 Muret e ndërtesës së ndalimit kanë parë këtë dhunë të
20 tmerrshme përtej fjalëve që mund të përshkruajnë këtë tmerr.
21 Ndërsa viktimat e ngjarjeve për të cilat akuzohen në këtë rast
22 kanë vuajtur krimet që janë në këtë aktakuzë, kanë vuajtur
23 pasojat të përjetshme për shkak të vuajtjes të tyre në
24 fabrikën e metalit. Kjo fotografi që po ju tregohet tani në
25 ekran është bërë në vitin 2009. Që nga ajo kohë ndërtesa është

1 prishur dhe dhomat e ndalimit janë zhdukur. Sot, vetëm një
2 pjesë e vogël e saj, tani që shihet në fotografinë e madhe në
3 ekran me mure tulle në pjesën e fundit, në fund të fotografisë
4 fare, ngelet vetëm kjo pjesë e vogël pra.

5 Kemi dëgjuar disa dëshmitarë të Mbrojtjes në këtë gjykim
6 të cilëve nuk ju kujtohej kjo ndërtesë. Të shohim këtë dhe një
7 herë dhe të shohim një pamje nga ajri të këtyre objekteve.

8 Në fotografinë e bërë nga ajri, mund të shohim se toka
9 mbi të cilën ishin ndërtesat përmban akoma hijen e ndërtesës
10 së ndalimit që ishte aty më herët. Shenja ngjyrë blu e
11 fabrikës së metalit, që shihet në ekran, nuk lë dyshim për
12 ekzistencën e kësaj ndërtese dhe dimensioneve të saj. Në qoftë
13 se i bashkojmë këto pra, shënimin ngjyrë blu dhe fotografinë e
14 bërë nga ajri në drejtim të veriut dhe vëmë një planimetri mbi
15 fotografinë e bërë nga ajri shfaqet një ndërtesë që përputhet
16 me pjesët që kanë ngelur nga ndërtesa e ndalimit që mund të
17 shihet në fotografinë nga ajri dhe me të njëjta konture
18 konkrete siç shihet në fotografinë e bërë përballë, nga pjesa
19 përpara në vitin 2009. Në mes të oborrit, midis depove të
20 përdorura, nga magazina të përdorura nga UÇK-ja, në anën e
21 tualeteve, është e pamundur të mos shihet dhe siç është
22 përshkrua dhe nga viktimat.

23 Tani do t'ia kaloj fjalën znj. Pergolo, koleges time, e
24 cila do të flasë për dy incidente konkrete për të cilat janë
25 ngritur akuza në këtë rast.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Faleminderit, znj. Prokurore.

3 Do të vazhdojmë, siç kemi bërë dhe më herët, deri në orën
4 11.00, pastaj do bëjmë një pushim pak më parë ose pak më pas,
5 varësisht sesi mund t'i përshtatet edhe paraqitjes edhe
6 prezantimit tuaj.

7 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Mirëmëngjesi, të nderuar
8 Gjykatës. Mirëmëngjesi të gjithëve të pranishëm në sallë apo
9 jashtë sallës.

10 Do të vazhdojmë prezantimin tonë lidhur me krimet dhe
11 vendet e krimeve duke shtjelluar këtu dy incidentet për të
12 cilat janë ngritur akuza në këtë çështje që është trajtimi
13 mizor, tortura dhe vrasja.

14 Por ju, të nderuar Gjykatës dhe palë të tjera dhe
15 pjesëmarrës, pjesët në dosjen përfundimtare relevante lidhur
16 me këtë pika mund të gjenden në pjesën 5E dhe 5F.

17 Nuk do të përsëris tregimin e hollësishëm të këtyre
18 incidenteve, i cili gjendet në dosjen përfundimtare që kemi
19 paraqitur. Do të bëj një përmbledhje të shkurtër të tyre.
20 Pastaj do të trajtoj kundërshtimet konkrete të ngritura nga
21 Mbrojtja lidhur me këto ngjarje.

22 Dhe me qëllim që të respektojmë masat mbrojtëse të cilat
23 janë urdhëruar nga ky Trupi Gjykes, kërkoj që të kalojmë në
24 seancë private për këtë pjesë të prezantimit tim. Prezantimi
25 vizual që shoqëron prezantimin tim gojor, të nderuar Gjykatës,

1 nuk duhet të shfaqet për publikun.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.
3 Prokurore, pra, kërkesa juaj është që të kalojmë tani në
4 seancë private?

5 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Po.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju
7 lutem na kaloni në seancë private.

8 [Seancë private]

9 [Seancë private teksti i fshirë]

10

11

10 Gjykatës, ne e dimë që i akuzuari ka qenë në fabrikën e
11 metalit në Kukës rreth datës 3 qershor 1999, dita kur i
12 akuzuari ka marrë pjesë në incidentin që diskutuam në detaje
13 në Pjesën F të dosjes së Prokurorisë.

14 Ne e dimë që kjo dëshmi vjen nga dëshmitari numër 1, dhe
15 do bëj disa parashtrime shtesë lidhur me besueshmërinë e tij.
16 Por për momentin dua të them që dëshmia e tij në lidhje me
17 këtë pikë konfirmohet nga dëshmitari 4379, personi shqiptar,
18 një burrë shqiptar, pra, që i kishte lejuar UÇK-në të përdorte
19 fabrikën e metalit në Kukës të cilën e kemi shtjelluar në
20 seksionin 5 të dosjes tonë gjyqësore.

21 Mbrojtja ka cituar dëshminë e dëshmitarit 4379 në dosjen
22 e tyre, por në mënyrë disi selektive dhe ka thënë se 4379 e
23 kishte takuar të akuzuarin në fabrikë pas luftës. Në fakt e
24 thonë në një rresht të dosjes të tyre, por ka edhe disa gjëra
25 të tjera që Mbrojtja nuk i ka thënë.

1 Duhet lexuar e plotë dëshmia e Dëshmitarit 4379 sepse ai
2 e ka takuar të akuzuarin në fabrikë përpara përfundimit të
3 luftës kur i akuzuari kishte transportuar për në Kukës ata që
4 ishin plagosur dhe vrarë gjatë bombardimit të Gorozhupit. Ne e
5 dimë edhe nga një dëshmitar tjetër, 3887 që ky bombardim, këtë
6 granatim, është mbajtur më datën 31 maj 1999, edhe janë
7 mbajtur edhe disa funerale të këtyre viktimave mes datës 1 dhe
8 4 qershor 1999 dhe në to kanë marrë pjesë një numër i madh
9 ushtarësh të cilët pas funeraleve u kthyen në vijën e frontit.

10 Fatkeqësisht, edhe Dëshmitari 4379 ka vdekur jo shumë
11 kohë para se të jepte dëshminë në këtë proces gjyqësor.

12 Ne nuk po themi, të nderuar Gjykatës, që ju të
13 mbështeteni veçanërisht në dëshminë e tij për të konstatuar se
14 i akuzuari ka qenë i pranishëm në fabrikë në këtë. Dëshmitari
15 numër 1 është burimi kryesor për faktin që i akuzuari ka qenë
16 i pranishëm. Megjithatë, 4379 ka dhënë dëshmi të fortë
17 konfirmuese lidhur me këtë aspekt.

18 Dhe me këtë, dua të mbyll parashtrimin tonë sa i takon
19 pranisë së të akuzuarit në fabrikën e metalit në Kukës dhe
20 pjesëmarrjen e tij në krime që vërtetohet përtej dyshimit të
21 arsyeshëm nga dëshmitë që kemi marrë.

22 Tani dua të diskutoj pjesëmarrjen e tij si person
23 përgjegjës penalisht në këto vepra penale.

24 Nuk dua të përsëris parashtrimet që kemi bërë në dosjen
25 tonë, por do të doja të flisja për disa kundërshtime që ka

1 ngritur Mbrojtja sa i takon përgjegjësisë së tij penale.

2 Unë do përmbledh parashtrimin e ZPS-së në atë drejtim
3 para se të vijoj më tej.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
5 Prokuror, po shoh orën.

6 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. E shoh dhe
7 unë orën. Më mirë të bëjmë pushimin tani dhe të rifillojmë pas
8 pushimit.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë,
10 atëherë.

11 Jemi në seancë publike. Atëherë, unë po them që sot
12 pushimin e drekës do ta bëjmë deri në orën 13.45 dhe më pas
13 vijojmë, bëjmë seancën, bëjmë një çerek ore pushim pastaj
14 bëjmë prapë gjysmë ore, pastaj e mbyllim në orën 16.00.

15 Në rregull, atëherë. Seanca ndërpritet këtu, rikthehem
16 në orën 13.45.

17 --- Pauza e drekës fillon në orën 12.39

18 --- Seanca rifillon në orën 13.48

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë
20 se u kthyet të gjithë.

21 Po i hedh një sy një herë. ZPS-ja ka të njëjtët
22 pjesëmarrës. Faleminderit. Mbrojtësi i Viktimave.

23 Mbrojtja?

24 Z. GILISSEN: [Përkthim] Po, ama kemi një ndryshim tjetër
25 të vogël. Kemi dhe znj. Coralie Jobert Valla që është

1 stazhiere.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
3 Shala, ju më dëgjoni?

4 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, ju dëgjoj mirë.
5 Faleminderit.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë.
7 Fjala është për ZPS-në.

8 Z. Prokuror, fjala është për ju. Ju lutem, na thoni nëse
9 është nevoja të kalojmë në seancë private. Faleminderit.

10 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Fillimisht, duam t'ju
11 informojmë që ne do mbarojmë sot. Sot, domethënë, i
12 përfundojmë parashtrimet tona.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
14 Faleminderit që na vutë në dijeni.

15 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Pra, përpara pushimit, unë do
16 të flisja lidhur me përgjegjësinë penale të të akuzuarit si
17 pjesëmarrës në ndërmarrje të përbashkët kriminale.

18 NPK-ja, siç përshkruhet në aktakuzë është qëllim, për
19 qëllim të përbashkët kishte të merrnin në pyetje ose të
20 keqtrajtonin të ndaluarit në fabrikën e metalit të Kukësit.
21 Dhe këtu përfshihen veprat penale të ndalimit arbitrar, të
22 trajtimit mizor, torturës dhe vrasjes së paligjshme.

23 I akuzuari ka kontribuar në mënyrë të konsiderueshme për
24 këtë qëllim të përbashkët dhe ka pasur synimin apo dashjen për
25 t'i kryer këto vepra penale.

1 Anëtarë të kësaj NPK-je, krahas të akuzuarit, janë
2 Xhemshit Krasniqi, Sabit Geci dhe ushtarë të tjerë të UÇK-së
3 si dhe policë, përfshirë këtu persona që identifikohen si
4 Bedriu apo Van Dami.

5 Dëshmia për ekzistencën e NPK-së dhe përgjegjësinë penale
6 të të akuzuarit, pra, për pjesëmarrje në vepra penale
7 diskutohet apo më qartë shprehet në paragrafin 357, 373 të
8 dosjes së Prokurorisë.

9 Tani do doja të flisja më konkretisht lidhur me këto
10 parashtrime. Do të filloj me parashtrimet e Mbrojtjes sa i
11 takon ekzistencës së qëllimit të përbashkët kriminal që
12 përshkruhet në dosjen tonë.

13 Në paragrafët 77, 81 dhe 144 të dosjes paraprake,
14 Mbrojtja thotë që Prokuroria nuk ka arritur të vërtetojë që
15 një grup personash, ku përfshihet edhe i akuzuari, ishin
16 pajtuar apo kishin rënë dakord të ndiqnin një plan të
17 përbashkët kriminal që përmendët në aktakuzë. Po ashtu thotë
18 që nuk ka asnjë dëshmi për komunikim të drejtë, e të tërthortë
19 mes anëtarëve të pretenduar të NPK-së.

20 Parashtrimet bazohen në interpretimin e gabuar të ligjit
21 sa i takon NPK-së, por gjithashtu kanë shtrembëruar faktet.

22 Në mënyrë që të ekzistojë NPK-ja nuk ka nevojë që të
23 vërtetohet se ka pasur pajtim paraprak. Prokuroria nuk ka pse
24 të vërtetojë që plani ishte dakordësuar paraprakisht apo
25 formuluar paraprakisht, plani mund të materializohet në çast

1 dhe ekzistenca është e vërtetuar nga veprimet e dirigjuara të
2 këtyre anëtarëve të NPK-së.

3 Pjesëmarrja e të akuzuarit, sidomos në incidentin më 20
4 maj 1999, në fakt këtu janë të gjithë anëtarët e NPK-së ku
5 përfshihet dhe i akuzuari, është incidenti që është diskutuar
6 në pjesën V.F të dosjes sonë paraprake apo fakti, për faktin
7 që i akuzuari ka transportuar Dëshmitarin 4733 drejt fabrikës
8 së metalit në Kukës, ku ky person u mor në pyetje dhe u rrah.
9 Të gjitha këto në vetvete janë shembuj të qartë të veprimeve
10 të dirigjuara mes këtyre personave.

11 Edhe dëshmi të faktit që ka pasur veprimtari të
12 dirigjuara janë në fakt të vërtetuara, janë të thëna dhe vetë
13 nga i akuzuari. Ai ka thënë në paragrafin 205 të dosjes së
14 Prokurorisë se ka rrahur disa nga viktimat pasi ia kishte
15 kërkuar këtë Sabit Geci, që është një nga anëtarët kryesorë të
16 NPK-së, Ndërmarrjes të Përbashkët Kriminale.

17 Mbrojtja po ashtu argumenton se i akuzuari nuk mori pjesë
18 në disa nga veprimet konkrete që janë pjesë e krimeve që
19 kategorizohen si qëllim i përbashkët. Dhe parashtimi kryesor,
20 për shembull, pra, atyre, sa i takon ndalimit arbitrar, në
21 paragrafin 82 dhe 86 të dosjes së tyre është i shtjelluar
22 pikërisht në formën që e keni parë, të nderuar Gjykatës.
23 Megjithatë, ju e dinit, të nderuar Gjykatës, që NPK-ja nuk
24 kërkon domosdoshmërisht vetëm një formë të një vepre penale,
25 por të pjesshëm të një vepre penale. Por ajo që nevojitet

1 është që të kontribuohet në njëfarë mënyre për materializimin
2 e një plani.

3 Pra, siç thotë Mbrojtja në paragrafët 49 dhe 59 të dosjes
4 së tyre, pra, nuk mjafton ajo që thotë Mbrojtja që i akuzuari
5 nuk ka pasur asnjë gisht në lirimin e të ndaluarve apo a ka
6 qenë ai përgjegjës për këta persona gjatë ndalimit të tyre.
7 Siç përmendet, në paragrafin 83. Nuk ka rëndësi nëse i
8 akuzuari kishte ndonjë rang, ndonjë gradë të caktuar, as nuk
9 ka rëndësi se sa arrestime, në sa arrestime ka marrë pjesë.

10 Sidoqoftë, edhe pse kontributi në vetvete mund të mos
11 ketë qenë penal, i akuzuari, faktikisht, ka marrë pjesë në
12 këto krime. Ne e kemi përsëritur këto tashmë disa herë dhe
13 këtu po flasim për dëshmitë që janë përshkruar në Seksionet
14 V.A.3, V.D, V.F të dosjes së Prokurorisë.

15 Më tej, sikurse e kemi shtjelluar në paragrafin 363 të
16 dosjes së Prokurorisë, kontributi i të akuzuarit në planin e
17 përbashkët kriminal ka qenë i konsiderueshëm.

18 Sa i takon kuadrit --

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
20 Prokuror, po shihja pak transkriptin dhe nuk janë reflektuar
21 të gjitha pjesët e dosjes që përmendët ju.

22 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Mund t'i përsëris nëse është
23 nevoja. Fola një çik shpejt, në fakt.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
25 fakt, po, është më mirë të flisni ngadalë kur përmendni numra.

1 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Patjetër.

2 Unë përmenda Seksionin V.A.3 që është pjesa që diskutohet
3 transporti 4733 nga Romanati drejt Kukësit; përmenda V.D
4 [Sipas përkthimit] dhe pjesën V.F të dosjes së Prokurorisë.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Faleminderit për këtë. Shoh gjithashtu që keni thënë:

7 "... sikurse u tha në paragrafin 363 të dosjes së
8 Prokurorisë, kontributi i të akuzuarit në këtë plan ka qenë i
9 konsiderueshëm".

10 Më duket sikur mungon diçka këtu.

11 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Jo, jo. Këtë fjali kisha unë.
12 Këtë fjali kisha; këtu do vazhdoja, në fakt, kur më ndërpretë
13 ju.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
15 rregull, mund të vazhdoni atëherë.

16 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Atëherë, Mbrojtja bën
17 parashtrime në lidhje dhe me kuadrin e pjesëmarrjes së të
18 akuzuarit në NPK dhe thonë që nuk ka asnjë dëshmi se ka marrë
19 pjesë në disa nga krimet apo që ka keqtrajtuar disa prej
20 viktimave. Për shembull, dëshmitari me numër TW4-11. Kjo është
21 reflektuar më konkretisht në paragrafët 112 deri në 120 të
22 dosjes së Mbrojtjes.

23 Të nderuar Gjykatës, që i akuzuari të jetë përgjegjës për
24 planet që janë, për krimet, më falni, që janë pjesë e planit
25 të përbashkët nuk është e nevojshme që ai të ketë marrë pjesë

1 në çdo aspekt të mundshëm të atij plani. Jurisprudenca
2 përkatëse lidhur me këtë burojnë që nga çështje pas Luftës së
3 Dytë Botërore dhe thuhet, "Përgjegjësia për pjesëmarrje në një
4 plan penal është po aq e gjerë saqë është dhe vetë plani".

5 Bazuar në këtë parim, në rastet kur dëshmitë vërtetojnë
6 se në fakt ka pasur një plan të përbashkët kriminal dhe se i
7 akuzuari ka dhënë një kontribut të konsiderueshëm në këtë
8 plan, sepse ka pasur synimin për të qenë pjesë, atëherë i
9 akuzuari është përgjegjës jo vetëm për kontributin e tij të
10 drejtpërdrejtë, por edhe veprimet e anëtarëve të tjerë të NPK-
11 së që kanë qenë pjesë e planit kriminal dhe kur e dinin se
12 çfarë pasojash do të kishte ky plan. Pra, e thënë ndryshe
13 është përgjegjës edhe për personat që s'kanë qenë anëtarë të
14 NPK-së për sa kohë këto veprime janë kryer në zbatim të një
15 plani të dakordësuar paraprakisht.

16 Jurisprudenca për këtë aspekt është e mirëvendosur, është
17 e qartë. Unë mund t'ju përmend edhe një rast të TPNJ-së të 3
18 prillit 2007, është çështja aktgjykimi i Brdjanin e 3 prillit
19 2007 [Sipas përkthimit].

20 Sa i takon kuadrit të përgjegjësisë penale të të
21 akuzuarit po ashtu do ju lutesha, të nderuar Gjykatës, t'i
22 referoheni paragrafit 423 të aktgjykimit të apelit të
23 Brdjanin.

24 Unë e kam përsëritur disa herë se si aspekte të
25 rëndësishme të përgjegjësisë së NPK-së në thelb, në vetvete

1 kanë synimin, dashjen. I akuzuari duhet të ketë pasur synimin
2 për të kryer krimet. Në paragrafët 363 dhe 364 të dosjes sonë
3 ne kemi shtjelluar pse ka ekzistuar ky synim. Dhe ekzistenca e
4 këtij synimi është pikërisht veprimi, pjesëmarrja e
5 vazhdueshme në krimet dhe pjesëmarrja e qëllimshme në rrahjen
6 e të ndaluarve. Megjithatë, nuk është vetëm kjo dëshmi.

7 Është dhe deklarata e tij që ka thënë që i kam rrahur dhe
8 që do t'i rrihte prapë këto viktima pa asnjë lloj mëdyshje për
9 këtë. Kjo është e diskutuar në paragrafin 405 të dosjes së
10 Prokurorisë.

11 Mbrojtja parashton se krimet që janë kryer në fabrikën e
12 metalit në Kukës ishin motivuar nga hakmarrje personale.
13 Ndonëse disa prej dëshmitarëve e kanë thënë këtë që ka qenë
14 edhe kjo pikëpamja e tyre, sepse ka pasur disa konflikte
15 paraprake me disa nga kryesit e tyre dhe këto mund të kenë
16 qenë arsye për keqtrajtimin e tyre. Ama mbetet fakt, dhe ka
17 dëshmi në këtë drejtim, që të gjithë janë akuzuar se kishin
18 lidhje me shtetin serb. Për këtë kemi përmendur shumë aspekte
19 në dosjen tonë paraprake. Më konkretisht do ju lutesha t'i
20 drejtoheshit paragrafit 58, 59, më falni, 99, 100, [Sipas
21 përkthimit] 139 dhe 145 të dosjes sonë.

22 Këto akuza janë ngritur kundër të akuzuarit dhe kjo në
23 fakt ne e dimë edhe nga deklaratat e dhëna vetë nga i
24 akuzuari. Përkatësisht nga ajo çfarë ka thënë ai lidhur me
25 dëshmitarët, që janë dëshmitarë, dy dëshmitarë 4733 dhe dy

1 dëshmitarë të tjerë, duke filluar këtu nga faqja 8 e
2 deklaratës së 2016, lidhur me dëshmitarin e fundit.

3 Në çdo rast, të nderuar Gjykatës, ka të dhëna që motivet
4 personale nuk kanë qenë arsytet për keqtrajtimin. Megjithatë,
5 motivet personale nuk janë përcaktuese sa i takon akuzave të
6 ngritura në aktakuzë për NPK-në.

7 Tani do flas për synimin e të akuzuarit për vrasje më
8 konkretisht.

9 Dëshmitë vërtetojnë përtej dyshimit të arsyeshëm që i
10 akuzuari ka pasur si synim në mendjen e vet dhe ky synim ka
11 ekzistuar gjithashtu edhe në anëtarët e tjerë të NKP-së dhe
12 këtu për referencë dua t'ju përmend paragrafët 366 deri në 372
13 të dosjes përfundimtare të Prokurorisë. Sa i takon kësaj pike
14 më lejoni të kujtoj diçka që ka thënë Xhemshit Krasniqi, pra,
15 çfarë u ka thënë ai viktimave përpara sesa të qëllohej, të
16 gjuhej me armë drejt tyre. Ai ka thënë, dhe do citoj: "Nesër
17 vetëm njëri prej jush do jetë gjallë, por jo të dy, por jo të
18 dy do jeni gjallë". Për procesverbal këtë mund ta gjeni në
19 dëshminë e dhënë nga dëshmitari 01.

20 Atëherë sa i takon parashtrimeve shtesë, lidhur me
21 synimet, më duhet që të kaloj në seancë private në mënyrë të
22 tillë që të respektojme masat mbrojtëse. Gjithashtu do të më
23 duhet që të qëndroj ndoshta 2 ose 3 minuta në seancë private.

24 Dhe pastaj do kërkoja që të kalojmë përsëri në seancë
25 publike.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
2 Sekretare, ju lutem na kaloni na kaloni në seancë private.

3 [Seancë private]

4 [Seancë private teksti i fshirë]

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11 [Seancë e hapur]

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
13 jemi në seancë publike.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund
15 të vazhdoni z. Prokuror.

16 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, synimi për
17 të vrarë siç përshkruhet në dosjen e Prokurorisë rezulton dhe
18 buron qartazi nga sjellja e vazhdueshme e kryesve.

19 Për shembull, gjatë incidentit të 20 majit të vitit 1999
20 të paktën tri vetë janë, janë persona të cilët ishin të
21 armatosur me armë dhe nuk flasim për persona të cilët thjesht
22 kishin armë në trup, por kishin armë në dorë dhe dy prej tyre
23 i kanë përdorur ata për të qëlluar në kokë dy prej viktimave,
24 duke shkaktuar lëndime, plagë dhe prerje. Po ashtu ushtarët
25 kishin dhe objekte të mprehta, si për shembull, thika.

1 Njerëzit janë gjuajtur me grusht fort në kokat e tyre;
2 kanë rrjedhur gjak dhe në mënyrë të përsëritur kanë humbur
3 vetëdijen. Më pas, pas fanitjeve e merrnin përsëri veten dhe
4 rriheshin përsëri dhe si rezultat prapë e humbnin vetëdijen.
5 Një proces ky i cili ka vazhduar gjatë gjithë natës.
6 Pavarësisht dhunës së ushtruar të vazhdueshme, i akuzuari ka
7 vazhduar që të marrë pjesë në të, gjatë incidentit kryesor më
8 datë 20 maj dhe më pas në qershor.

9 Dëshmitari 1448, një prej viktimave të rrahjes, ka thënë
10 që "ai nuk ka parë tortura të tilla që të ndodhnin ndonjëherë
11 as edhe në filma, s'i ka parë tortura të tilla".

12 Një natë përpara qëllimit, gjuajtjes me armë zjarri janë
13 dëgjuar të shtëna të tjera duke mos lënë asnjë lloj dyshimi sa
14 i takon viktimës së vrasjes.

15 Mbrojtja ka qëndrimin që ndryshime të caktuara në kushtet
16 e ndalimit pas vdekjes së viktimës së vrasjes tregojnë që
17 kryesit nuk kanë pasur synimin për ta vrarë atë. Megjithatë,
18 të nderuar Gjykatës, veprimet e marra pas faktit për të mos
19 ndryshuar dëshmitë e diskutuara më sipër dhe së dyti të
20 nderuar Gjykatës, ajo çfarë është e rëndësishme është që nuk
21 ishte Xhemshit Krasniqi që ka urdhëruar ndryshimin e kushteve,
22 por në fakt Xheladin Gashi, ose Plaku, ka kërkuar ndryshimin e
23 kushteve të tilla që ndoshta ishte edhe oficeri më i lartë
24 aty. Dhe i udhëzoi rojat e tjera që të mos dëmtonte apo të mos
25 lëndonte të ndaluarit e tjerë. Këtë e kemi mësuar nga një prej

1 personave të pyetur.

2 Mbrojtja parashtroi që i akuzuari nuk ishte në pozitë që
3 të ofronte asnjë lloj ndihme shëndetësore. Megjithatë,
4 rrethanat, të nderuar Gjykatës, nuk e përjashtojnë të
5 akuzuarin nga përgjegjësia penale në kuadrin e NPK-së. Dhe
6 sikurse e kemi diskutuar më përpara, pra, për aq kohë sa
7 ekzistojnë elementët e tjerë të formës së përgjegjësisë
8 penale, i takon që ai ka marrë pjesë në çdo komponent, se nuk
9 është e nevojshme që shprehimisht të ketë marrë pjesë në çdo
10 komponent apo në çdo aspekt që ka të bëjë me NKP-në. Në çdo
11 rast i akuzuari dhe pozita e privilegjuar e tij dhe niveli i
12 qasjes së tij në fabrikën e metaleve në Kukës do e ketë bërë
13 atë të ketë mundësi që ta ndihmonte viktimën apo që të mbronte
14 në mënyrën tjetër viktimat. Në fakt ai jo vetëm që nuk e ka
15 bërë këtë gjë, por vite pas ngjarjes është shprehur që do të
16 bënte të njëjtën gjë dhe do të bënte, do të kryente të njëjtat
17 rrahje sërish.

18 Të nderuar Gjykatës, akuzat e ngritura në aktakuzë për të
19 akuzuarin në alternativë janë vrasje në formën e tretë të NKP-
20 së. Domethënë, me fjalë të tjera, që edhe në qoftë se ndoshta
21 ai nuk e ka kryer vetë vrasjen duhet të ishte e parashikueshme
22 prej tej që mund të ndodhte vrasja, kjo jepet në paragrafin
23 184 të dosjes tonë. Në fakt sikurse e përshkrova atë më sipër
24 që jo vetëm që vrasja ka qenë e parashikueshme, por ekzistonte
25 dhe elementi i synimit për kryerjen e kësaj vrasje nga

1 kryesit.

2 Secili prej faktorëve që unë përmenda më sipër nuk lënë
3 asnjë hapësirë për interpretim ndryshe të fakteve.

4 Të nderuar Gjykatës, kam mbërritur tani në pjesën e
5 fundit të parashtrimeve të Prokurorisë që ka të bëjë me
6 besueshmërinë e dëshmitarit 1 të Prokurorisë.

7 Do filloj këtë pjesë në seancë publike, por për pak
8 minuta, të nderuar Gjykatës, do ju kërkoj që të kalojmë në
9 seancë private.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
11 Faleminderit.

12 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Historia e Dëshmitarit numër 1
13 lidhur me atë çfarë ka vuajtur në fabrikën e metaleve në Kukës
14 është e besueshme. Të nderuar Gjykatës, dëshmitari e njihte të
15 akuzuarin dhe i akuzuari e njihte atë.

16 Edhe pse bashkëpunimi nuk është kërkesë sikurse
17 diskutohet në seksionin përkatës të dosjes dëshmia e tij është
18 mjaftueshëm e konfirmuar sa i takon identifikimit të
19 viktimave, natyrës së keqtrajtmeve, vendit të ndalimit si dhe
20 rolit të të akuzuarit. Kur dëshmia e tij nuk është në mënyrë
21 të drejtpërdrejtë mbështetëse ose konfirmuese, ndodh atëherë
22 kur personi që bën konfirmimin nuk ka pasur mundësi që të vijë
23 që të japë dëshmi këtu.

24 Mbrojtja thotë që, në fakt e gjithë dëshmia e këtij
25 personi është e fabrikuar, po ashtu ai thotë që Mbrojtja,

1 synon ose thotë shprehimisht që "synimi kryesor i këtij
2 personi ka qenë që të gënjente". Më tepër Mbrojtja parashtron
3 që dëshmitari ka dashur të marrë hak ose të hakmerrej.

4 Pyetje që kemi ne si Prokurori është, të hakmerrej kundër
5 kujt? Nuk ka absolutisht asnjë arsye tjetër të mundur që buron
6 nga dëshmia e këtij gjykatësi përveçse të japë mendimin e tij
7 sa i takon sjelljes kriminale të të akuzuarit.

8 Tani të nderuar anëtarë të Trupit Gjykues do ju kërkoj që
9 të kaloni në seancë private.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
11 rregull.

12 Znj. Sekretare, ju lutem na kaloni në seancë private.

13 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Parashikoj që do më duhet
14 dhjetë minuta për të përfunduar parashtrimet në seancë
15 private.

16 [Seancë private]

17 [Seancë private teksti i fshirë]

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10 [Seancë e hapur]

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
12 jemi në seancë publike.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
14 Faleminderit.

15 Z. Prokuror, mund të vazhdoni.

16 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Lista e pretendimeve të
17 pambështetura kundër Dëshmitarit 1 vazhdon më tej.

18 Mbrojtja e akuzon atë që ka diskutuar haptazi procesin
19 gjyqësor me dëshmitarë potencialë dhe që ka fabrikuar
20 qëllimisht dëshmi kundër të akuzuarit. Kjo gjendet në
21 paragrafin 202 të dosjes përfundimtare të Mbrojtjes.

22 Shembulli i parë i pretenduar i kësaj sjellje që jepet në
23 poshtëshënimin 449 të paragrafit 202 të dosjes së Mbrojtjes,
24 nuk tregon asgjë me pavend të sjelljes së Dëshmitarit 01.

25 Dëshmitari 01 e dinte që ky person mund të ishte dëshmitar i

1 vuajtjeve të tij dhe ai dëshironte që ai ta dëgjonte diçka të
2 tillë. T'i kërkosh dikujt që të japë dëshmi për atë çfarë ka
3 parë apo për çfarë ka ndodhur nuk është dëshmi se ti ke ndikim
4 jo të përshtatshëm mbi një dëshmitar.

5 Sa i takon dëshmitarëve të tjerë të renditur në të
6 njëjtin poshtëshënim që sipas Mbrojtjes vërtetojnë që ai ka
7 fabrikuar në mënyrë të qëllimshme dëshminë e tyre.

8 Prokuroria dëshiron që t'ju tërheqë vëmendjen që të
9 shikoni dokumentin 060664-TR-ET Pjesa 5 RED4, faqet 2 deri në
10 3. Dhe ky është një shembull, kjo është një shembull që një
11 viktimë thjesht ndan përvojën e vet me një viktimë tjetër.
12 Ndërkohë që nuk ka asgjë pavend për të gjithë këtë.

13 Së fundi, dëshmitari tjetër ose dëshmitari i tretë që
14 përdoret nga Mbrojtja, për sa i takon pretendimit për
15 fabrikimin e qëllimshëm të këtij dëshmitari është Dëshmitari
16 01448.

17 Është një dëshmitar për të cilin ne folëm edhe më herët
18 gjatë parashtrimeve të sotme. Pra, Dëshmitari 01 që i ka thënë
19 Dëshmitari 1448 në kohën e ndalimit identitetin e personit që
20 i kishte rrahur ata, në fakt nuk ka pikë lidhje me fabrikimin
21 e dëshmisë kundër të akuzuarit. Dhe nuk ka as lidhje edhe me
22 përpjekjet e Dëshmitarit 01 për fabrikimin e dëshmime më në
23 përgjithësi. Sepse, sikurse e thashë edhe më herët gjatë
24 parashtrimeve të mia në atë kohë as nuk është menduar që do të
25 bëhej një proces gjyqësor sa i takon jetës së personave.

1 Ndërkohë nga ana tjetër diçka tjetër që thuhet është
2 pjesa e asaj çfarë jepet në paragrafin 219 të dosjes që
3 Mbrojtja thotë që 01-shi, pra, Dëshmitari 01 nuk e ka
4 identifikuar rojën që ka qenë te porta. Kjo nuk është e
5 vërtetë.

6 Së fundi, vijojmë më tej me historinë e lirimit të
7 Dëshmitarit 01. Historia e lirimit të Dëshmitarit 01
8 konfirmohet nga dëshmia e dëshmitarit nga raporti i ngjarjeve
9 dhe gjithashtu edhe nga Dëshmitari 1448. Ajo çfarë identifikon
10 Mbrojtja në paragrafët 225, 226 të dosjes së vet janë hollësi
11 të vogla të cilat nuk hedhin pikë dyshimi lidhur me faktin se
12 ku është mbajtur dhe më pas ku është liruar Dëshmitari 01. Dhe
13 as nuk është se ka ngritur ndonjë pretendim të ndryshëm as
14 vetë dëshmitari lidhur me këtë fakt.

15 Në përfundim, të nderuar Gjykatës, dëshmia e Dëshmitarit
16 01 është e besueshme dhe e mbështetshme. Identifikimi i të
17 akuzuarit prej tij nuk mund të vihet fare në pyetje, sepse
18 vetë i akuzuari ka pranuar që ka pasur ndërveprime me të në
19 atë kohë.

20 Përveç kësaj nuk ka dëshmi që Dëshmitari 01 do të kishte
21 pasur ndonjë arsye për të implikuar të akuzuarin në diçka për
22 të cilën ai nuk ishte fare përgjegjës. Në fakt, të nderuar
23 Gjykatës, për këtë koment të fundit do ju kërkoj që të kalonim
24 përsëri shkurtimisht në seancë private.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

1 rregull.

2 Ju lutem, na kaloni në seancë private, znj. Sekretare.

3 [Seancë private]

4 [Seancë private teksti i fshirë]

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10 [Seancë e hapur]

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Znj. Gjykatëse, jemi në
12 seancë publike.

13 Z. DE MINICIS: [Përkthim] Me këtë përfundoj parashtrimet
14 e mia. Sot Prokuroria ka vërtetuar se i akuzuari është i
15 përgjegjshëm për krimet me të cilat janë të ngritura në
16 aktakuzë dhe përgjegjësia e tij është e bazuar në dëshmi të
17 besueshme dhe të sakta.

18 Tani do t'ia jap fjalën znj. Wyler për parashtrimet e
19 ZPS-së lidhur me dënimin.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
21 Faleminderit. Ju jap pak kohë që të ndërroni vend.

22 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Faleminderit.

23 Krimet e kryera nga i akuzuari justifikojnë dënim të
24 ashpër, pasqyrojnë peshën e tyre të rëndë, pasojat e rënda në
25 viktimat, rolin e të akuzuarit në tyre, praninë e faktorëve të

1 shumtë rëndues, mungesa e faktorëve zbutës dhe rëndësia e
2 parandalimit.

3 Lidhur me peshën e rëndë të krimeve të kryera nga i
4 akuzuari këto ish-in padyshim brutale dhe shkatërruese. Të
5 ndaluar pa asnjë paralajmërim, të hequr brutalisht nga
6 familjet dhe jetët e tyre të paktën 18 viktima u mbajtën të
7 ndaluar në kushte çnjerëzore në fabrikën e metalit në Kukës ku
8 u keqtrajtuan fizikisht dhe psikologjikisht dhe u torturuan.
9 Keni dëgjuar për vuajtjet e tyre gjatë ditës së sotme. Ata
10 kanë jetuar në frikë të vazhdueshme dhe për ta thënë me fjalët
11 e dëshmitarit në gjykatë numër 1, prisnin që të vriteshin në
12 çdo çast. Dhe në fakt, njëri prej viktimave nuk shpëtoi nga ky
13 ndalim në fabrikën e metalit në Kukës.

14 Krimet e të të akuzuarit kanë patur pasoja të tmerrshme
15 në të ndaluarit dhe familjet e tyre. Për viktimat krimet të
16 cilat kanë vuajtur ato kanë shkaktuar pasoja psikologjike dhe
17 fizike të gjëra dhe të gjata.

18 Dëshmitari numër 1 dëshmoi se nuk do të jetë kurrë më në
19 gjendje të harrojë kujtimet e asaj që ndodhi, që i ka ndodhur
20 në Kukës se ai nuk do të gjejë kurrë më qetësi në shpirt dhe
21 në mendje. Ai vazhdon sot që të vuajë, të ketë vuajtje fizike
22 dhe çrregullimet të stresit post-traumatik në mënyrë kronike
23 që lidhen me atë që ai ka përjetuar në fabrikën e metalit në
24 Kukës.

25 Dëshmitar 11 vuan akoma nga pasojat e plagëve që janë

1 shkaktuar në sy.

2 Më shumë se 15 vite pas ndalimit të tij Dëshmitari 04733
3 ka bërryllin dhe dorën të dëmtuar dhe shikimin e dëmtuar. Ai
4 vazhdon të vuajë nga ankthi dhe makthi dhe vite pas lirimit të
5 tij 04733 vazhdon të kishte frikë dhe ngurronte që të shkonte
6 të konsultonte një doktor në Kosovë, sepse kishte frikë se do
7 ta ndalonin përsëri.

8 Krimet e të të akuzuarit gjithashtu kanë traumatizuar në
9 mënyrë të pakthyeshme familjet e viktimave, të pariparueshme.
10 Të nderuar Gjykatës, keni dëgjuar tregimin e familjes së
11 viktimës këtu në gjykatë. "Ajo që na ka ndodh neve do të
12 qëndrojë me neve dhe nuk do të jemi kurrë në gjendje që ta
13 fshijnë këtë, ta harrojmë këtë", tha bashkëshortja e një
14 viktime. Kur bashkëshorti i saj dhe babai i fëmijëve të saj
15 erdhi në shtëpi kishte plagë, lëndime dhe mavijosje në të
16 gjithë trupin e tij. Ishte i palarë, i vinte erë e keqe, ishte
17 i zbehur, i dobët dhe pothuajse i binte të fikët.

18 Viktima ishte pjesëtar i rëndësishëm i familjes, baba i
19 dashur, i angazhuar në rritjen dhe edukimin e fëmijëve të tij.
20 E gjitha kjo ndryshoi pas ndalimit të tij në fabrikën e
21 metalit në Kukës e cila gjë që e la atë si një person
22 tërësisht ndryshe. Trauma e tij solli stres të
23 jashtëzakonshëm, vështirësi dhe vuajtje për gruan,
24 bashkëshorten dhe fëmijët e tij. "Me keqtrajtimin e babait
25 tim", tha njëri prej fëmijëve të tij, "Ne si familje jemi

1 trajtuar edhe ne, keqtrajtuar edhe ne". Ajo që ka ndodhur
2 babait të tyre, bashkëshortit të tyre, ka ndikuar, ka prekur
3 edhe familjen e tyre në tërësi. Ata janë etiketuar si familje
4 spiunësh dhe kishin frikë për sigurinë e tyre. Dy prej
5 fëmijëve u desh që të mos shkonin më në shkollë, të
6 ndërprisnin shkollën. Viktima siguronte ushqimin dhe jetesën e
7 familjes dhe tani nuk ishte më në gjendje të punonte për shkak
8 të kushteve gjendjes së tij psikologjike dhe mendore. Në të
9 njëjtën kohë trajtimet mjekësore dhe operacionet ishin të
10 shtrenjta dhe shkaktonin peshë të rëndë financiare në familje
11 që fëmijët e viktimës duhet ta merrnin përsipër.

12 Tani përmenda faktorët rëndues. Pësia e rëndë e krimeve
13 të të akuzuarit rëndohet edhe më tej nga fakti se viktimat
14 ishin veçanërisht të brishtë dhe të pambrojtur. Tërësisht nën
15 mëshirën e torturuesve të tyre, rrahjet dhe frika që iu ishte
16 futur atyre është bërë edhe, ka shtuar edhe më tej brishtësinë
17 e tyre dhe faktin që ishin të pambrojtur. Përveç kësaj, i
18 akuzuari dhe bashkëkryesit e tij kanë pasur një nivel tejet të
19 lartë të mizorisë kundër viktimave të shumta. Kolegia ime
20 përmendi dhe unë vetë përmendëm brutalitetin me të cilin i
21 kanë trajtuar të ndaluarit ata më herët në fjalën përmyllëse.

22 Njëra prej viktimave ishte më parë në gjendje të rëndë
23 dhe të brishtë kur u ndalua në fabrikën e metalit në Kukës për
24 shkak të një aksidenti që kishte pasur. Plagët e tij ishin të
25 qarta për të gjithë, përfshirë edhe të akuzuarin.

1 Mbrojtja përpiqet që të zvogëlojë peshën e rëndë të
2 krimeve në aktakuzë në paragrafin 354. Mbrojtja në dosjen e
3 tyre përfundimtare flet për krime me fushëveprim të kufizuar,
4 peshë të kufizuar dhe numrin e viktimave të prekur. Kjo është
5 arsye e mjaftueshme që të rikujtojmë vlerën e cila e
6 jashtëzakonshme dhe që nuk blihet me pare dhe të jetës
7 njerëzore dhe dinjitetit njerëzor. Çdo person i mbajtur i
8 ndaluar në kushte ndalimi çnjerëzore, siç u ka ndodhur
9 viktimave në fabrikën e metalit në Kukës, është i tepërt, një
10 më shumë sesa duhen. Çdo ngjarje e vetme e keqtrajtimit të
11 torturës është krim i rëndë. Çdo viktimë dhe çdo jetë e marrë,
12 e hequr është tepër dhe kjo shkatërron në mënyrë të përhershme
13 jetët e viktimave dhe familjeve të tyre.

14 Përmenda rolin e të akuzuarit. Kontributi personal i të
15 akuzuarit në krimet ka qenë i drejtpërdrejtë, i
16 konsiderueshëm, i qëllimshëm dhe tejet i dhunshëm. Dëshmitë
17 tregojnë se i akuzuari është i përfshirë personalisht në
18 arrestimin, ndalimin dhe keqtrajtimin e rëndë të viktimave të
19 cilët e kujtojnë shumë qartë veprimet e të të akuzuarit. Atyre
20 në veçanti ju kujtohet ai si njëri prej aktorëve kryesorë në
21 natën apo rreth natës të 20 maj 1999 dhe se si ai në mënyrë të
22 qëllimshme i keqtrajtoi ata njëri pas tjetrit.

23 Viktimat raportojnë se i akuzuari ka rrahur ata aq sa ka
24 mundur duke përdorur mjete të ndryshme. I akuzuari i ka
25 goditur 04733 me një shkop bejsbolli, me shkop gome në gjithë

1 trupin përshirë edhe kokën. Ai ka rrahur 01448 me shkop në
2 duar për një gjysmë ore kaq rëndë, saqë 01448 pothuajse i ra
3 të fikët. Dhe kur ka goditur goditjen e parë dëshmitarit 1 ai
4 po kishte një buzëqeshje në fytyrë.

5 Në këtë natë viktimat u rrahën deri në pikën ku nuk mund
6 të qëndrojnë në këmbë më. Ata u rrahën derisa humbëm vetëdijen
7 dhe rrahjet vazhduan kur viktimat u kthyen në vetëdije. Ata
8 ishin të mbuluar në gjak, të plagosur dhe në dhimbje të madhe.
9 Asnjëra prej këtyre arsyeve nuk ishte arsye e mjaft...,
10 asnjëra prej këtyre nuk ishte arsye e mjaftueshme që i
11 akuzuari të ndalonte. I akuzuari ka marrë pjesë në këto rrahje
12 gjatë gjithë natës. Ai nuk ka ndërhyrë në asnjë moment; nuk ka
13 treguar mëshirë. Në asnjë pikë nuk është larguar nga aty, në
14 asnjë moment.

15 Dhe kjo nuk i mjaftonte atij. Pas incidentit të 20 majit
16 '99 ai merr pjesë po ashtu në rrahjen e dhunshme të
17 dëshmitarit 01 dhe viktimës së vrasjes më ose rreth datës 3
18 qershor 1999, e përshkruar kjo nga dëshmitari 01 si rrahje më
19 e rëndë gjatë ndalimit të tij dhe që përfundoi me vrasjen e
20 viktimës së vrasjes.

21 Përpjekjet e të akuzuarit për t'i ikur apo për të
22 zvogëluar përgjegjësinë e tij për krimet në aktakuzë, duke
23 pretenduar se nuk ishte shef, udhëheqës, komandant apo dikush
24 që kishte autoritet apo kontroll. Po i referohem këtu
25 paragrafit 355 të dosjes përfundimtare të Mbrojtjes. Ndonëse

1 ai mund të mos ketë qenë formalisht i caktuar, emëruar si
2 komandant në fabrikën e metalit në Kukës, ai ishte figurë me
3 ndikim; ishte i afërt me personat që ishin me autoritet aty;
4 kishte qasje në ndërtesën e komandës dhe liri të pakufizuar të
5 lëvizjes, brenda dhe jashtë objekteve.

6 Në fakt në 2005 ai pretendoi se kjo ishte për shkak të
7 statusit të tij, statusi i tij që ai ishte liruar kur u akuzua
8 lidhur me vrasjen e Halil Gashit në Burrel.

9 Por i akuzuari ishte gjithashtu i përfshirë thellësisht
10 në kryerjen fizike të krimeve. Dëshmitë e paraqitura nga ZPS-
11 ja vërtetojnë këtë përtej dyshimit të arsyeshëm se si i
12 akuzuari përmes pjesëmarrjes së tij të drejtpërdrejtë të
13 qëllimshme dhe me pjesëmarrje fizike dhe si pjesëtar i një
14 ndërmarrje kriminale të përbashkët është përgjegjës për krimet
15 që për të cilat janë ngritur aktakuzat.

16 Dhe në fund, nuk ka faktorë zbutës. Rrethanat e
17 pretenduara nga Mbrojtja në dosjen e tyre përfundimtare në
18 paragrafin 356 deri 371 nuk përmbushin kriteret që të
19 konsiderohen si faktorë zbutës. Në kohën e ngjarjes i akuzuari
20 ishte njëri i rritur, 36 vjeçar, plotësisht i vetëdijshëm për
21 peshën e rëndë të veprimeve të tij dhe krimet që po kryente.
22 Asnjë nga individët e prezan..., rrethanave të prezantuara
23 individualisht paraekzistues ndaj krimeve të në aktakuzë nuk
24 mund të përdoren si justifikim për vendime për vendimet që ai
25 ka marrë. Asnjë nga rrethanat aktuale të paraqitura lidhur me

1 familjen e tij, gjendja shëndetësore plotësojnë kushtet e
2 standardet e jashtëzakonshme të parashikuara në jurisprudencë.

3 Lidhur me sjelljen e tij të pretenduar të mirë, ndërkohë
4 ZPS-ja referohet konstatimeve të Trupit Gjykues në vendimin e
5 datës, në rishikimin e 15 mbi paraburgimin F00766, paragrafi
6 26 dhe provat që referohen aty.

7 Duke patur parasysh sa më sipër, ZPS-ja kërkon që Trupi
8 Gjykues të caktojë dënimet të urdhërojë dënimet në vijim ndaj
9 të akuzuarit për krimet individuale për të cilat akuzohet:
10 Pika 1, ndalim arbitrar 8 vjet burg; pika 2, trajtim mizor, 15
11 vjet burg; pika 3, torturë, 20 vjet burg; dhe për pikën 4,
12 vrasje, 26 vjet burg.

13 Në përputhje me rregullin 163(4) të Rregullores, Trupi
14 Gjykues cakton një vendim të vetëm që pasqyron tërësinë e
15 sjelljes kriminale të të akuzuarit. ZPS-ja kërkon që të
16 caktohet ndaj të akuzuarit një dënim i vetëm prej 28 vjet
17 burg.

18 Të nderuar Gjykatës, Mbrojtja e përshkruan të akuzuarin
19 si "një ushtar i thjeshtë i UÇK-së i cili ndihmoi popullin e
20 tij për të luftuar në front". Këtu citoj paragrafin 355 të
21 dosjes së tyre përfundimtare. Provat në këtë çështje që kemi
22 ne në dispozicion, megjithatë, vërtetojnë se ai ishte
23 sigurisht edhe një tjetër person, një person i cili u ka bërë
24 18 persona, i ka futur në, i ka bërë viktimë të ndalimit
25 arbitrar, trajtimit mizor, torturës dhe vrasjes së njërit prej

1 tyre.

2 Me këtë, të nderuar Gjykatës, ZPS-ja përfundon
3 paraqitjen, fjalën e tyre përfundimtare. Faleminderit.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
5 Faleminderit, znj. Prokurore.

6 Tani duhet të bëjmë planifikim të mëtejshëm për ditën e
7 sotme.

8 Mbrojtës, i drejtohem Mbrojtësit të Viktimave. Propozoj
9 që të vazhdojmë nesër në mëngjes.

10 Z. LAWS: [Përkthim] Po.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kjo
12 do të thotë që do të përfundojmë këtu për sot dhe rishihemi
13 nesër. Në rregull.

14 Përpara që të mbyll këtë seancë për sot do të doja të di
15 nga Zyra e Prokurorisë ndonjë gjë për të paraqitur dhe të
16 trajtuar në këtë Gjykatën?

17 ZNJ. WYLER: [Përkthim] Jo.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]
19 Mbrojtëse i Viktimave, keni ndonjë gjë që dëshironi të
20 diskutoni?

21 Z. LAWS: [Përkthim] Dua të them që ne kemi dhënë një
22 vlerësim të afatit kohor. Natyrisht nuk kemi parë akoma
23 qëndrimin e Mbrojtjes dhe atë që ka për të thënë Mbrojtja. Do
24 të rishikojmë parashtrimet tona gjatë natës dhe në bazë të
25 asaj që edhe ZPS-ja e ka thënë deri tani, do t'ju japim, mund

1 të jemi pak më gjatë sesa mendoja.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit.

4 Avokati Mbrojtës, a keni diçka për të thënë?

5 Z. GILISSEN: [Përkthim] Vetëm një sekondë, e nderuar

6 Gjykatëse. Dëgjoj kolegun tim të nderuar dhe shpjegimet e tij

7 dhe dua të di nëse neve do ta marrim fjalën në mëngjes gjatë

8 paradites apo në fillim të pasdites?

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kjo
10 është -- Mbrojtësi i Viktimave mund të përgjigjet më mirë
11 ndoshta.

12 Z. LAWS: [Përkthim] Sigurisht gjatë mëngjesit.

13 Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit shumë.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në
15 rregull. U mor përgjigja për këtë. Në rregull.

16 Atëherë, ndërpresim, mbyllim seancën këtu për sot dhe
17 shihemi nesër në orën 09.30. Faleminderit të gjithëve për
18 pjesëmarrjen këtu.

19 Edhe seanca përfundon me këto.

20 --- Seanca mbyllet në orën 14.48

21

22

23

24

25